FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 112

Tiranë – E hënë, 15 qershor 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 26, datë 10.6.2020	Për marrjen e masave të përkohshme për mbështetjen e sektorit të turizmit	6303
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 452, datë 10.6.2020	Për emërim në detyrë	6304
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 454, datë 10.6.2020	Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë"	6304
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 455, datë 10.6.2020	Për kriteret dhe masën e kompensimit të qirasë së banesës dhe të ushqimit të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë	6306
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 456, datë 10.6.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 910, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për çështjet, objekt konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar	6307
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 457, datë 10.6.2020	Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave	6308
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 458, datë 10.6.2020	Për përcaktimin e faktorëve dhe të situatave që merren parasysh në vlerësimin e rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit	6310
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 460, datë 10.6.2020	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike, lidhur me ofrimin e ndihmës teknike dhe financiare për projektin "Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në qarkun e Beratit"	6311

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 461, datë 10.6.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 661, datë 7.8.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjave 110 kV dhe 220 kV, që lidhin kaskadën e Devollit me sistemin e transmetimit të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.....	6330
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 462, datë 10.6.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 599, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Ndërtimi i rrugës 'Dhimitër Konomi', në zonën e Ujit të Ftohtë, Vlorë"'.....	6332
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 463, datë 10.6.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 231, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Rehabilitimi i segmentit rrugor 'Pallati me Shigjeta – Rrethrrotullimi 'Shqiponja"', të ndryshuar.....	6333
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 464, datë 10.6.2020	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.....	6336
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 465, datë 10.6.2020	Për dhënien e bursave për nxënësit e shkollës së mesme profesionale "Peter Mahringer", Shkodër, për vitin shkollor 2020–2021.....	6336
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 466, datë 10.6.2020	Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për hapjen dhe mbylljen e institucioneve private të arsimit parauniversitar, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj.....	6337
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 467, datë 10.6.2020	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Arben Hysko.....	6347
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 468, datë 10.6.2020	Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese.....	6347
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 469, datë 10.6.2020	Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësinë Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese.....	6348
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 471, datë 6.1.2020	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Nikollaq Tasi Kanxheri.....	6350
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 472, datë 6.1.2020	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Bashkim Zano Ahmeti.....	6350
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 473, datë 6.1.2020	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Alfred Pando Buhaljoti.....	6350
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 197, datë 11.6.2020	Për miratimin e "Rregullave për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit".....	6350

AKT NORMATIV
Nr. 26, datë 10.6.2020

PËR MARRJEN E MASAVE TË PËRKOHSHME PËR MBËSHTETJEN E SEKTORIT TË TURIZMIT

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

1. Ky akt normativ ka për objekt përcaktimin e masave të veçanta që do të merren në sektorin e turizmit, për agjencitë e udhëtimit, operatorët turistikë dhe klientët e tyre, në ofrimin e një shërbimi udhëtimi, nga dita e shpalljes deri në përfundim të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga COVID-19.

2. Për qëllime të këtij akti normativ, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

a) "Klientë", turistët dhe personat e tjerë, si individë apo të organizuar në grup, që i ofrohet çdolloj shërbimi udhëtimi, përfshirë akomodimin në struktura pritëse për turistët, këshillim dhe ofrim i shërbimeve të udhëtimit me ajër, me tokë e me det, të ekskursioneve të organizuara, si dhe një sërë shërbimesh të tjera ndihmëse, që lidhen me industrinë e turizmit;

b) "Rimbursim", lëshimi i një kuponi (*voucher*) që korrespondon me të njëjtin shërbim, i cili i korrespondon vlerës/shumës totale të paguar/rezervuar ose vlera/shuma totale që duhet t'i kthehet klientit për shërbimin e parapaguar ose të rezervuar, sipas parashikimeve të këtij akti normativ;

c) "Shërbim i rezervuar", një pjesë e pagesës që klienti ka kryer në momentin e rezervimit të shërbimit të udhëtimit.

Neni 2

Ky akt normativ ka për qëllim mbështetjen e sektorit të turizmit, për subjektet e përcaktuara në nenin 1, të këtij akti normativ, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke ofruar një balancim dhe siguri ekonomike në funksion të përmbushjes së kërkesave të klientëve, në një mjedis të sigurt, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga COVID-19, në përputhje edhe me parashikimet e nenit 488 e në vijim, të Kodit Civil.

Neni 3

Operatorët turistikë apo agjencitë e udhëtimit, të cilët, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose si ndërmjetës, kanë marrë përsipër t'u ofrojnë klientëve çdolloj shërbimi udhëtimi apo një sërë shërbimesh të tjera ndihmëse, dhe këto shërbime janë të parapaguara ose të rezervuara përpara shpalljes dhe gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore, përjashtimisht detyrimeve të parashikuara shprehimisht në kontratë, të kryejnë rimbursimin e tyre, brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ.

Neni 4

Operatorët turistikë apo agjencitë e udhëtimit, që kanë lidhur kontrata ndërmjetësimi për shitjen e shërbimeve të ofruara nga furnizuesit e shërbimeve të udhëtimit me klientin dhe këto shërbime janë të parapaguara ose të rezervuara përpara shpalljes dhe gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore, përjashtimisht detyrimeve të parashikuara shprehimisht në kontratë, të kryejnë rimbursimin e tyre, brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ.

Neni 5

Klienti i një pakete udhëtimi apo dokumenti udhëtimi, nga/apo nëpërmjet agjencive të udhëtimit ose operatorit turistik, për shërbimet e udhëtimit të parapaguara përpara shpalljes dhe gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore, përjashtimisht detyrimeve të parashikuara shprehimisht në kontratë, përfiton rimbursimin e tyre brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ.

Neni 6

1. Në rast të pamundësisë së realizimit të kontratave të transportit të klientëve me mjetet e transportit ajror, si pasojë e masave kufizuese të ndërmarra për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga COVID-19, nga/dhe aeroporti ndërkombëtar "Nënë Tereza", Tiranë,

transportit detar nga të gjitha portet në vend ose ujërave të brendshme, subjektet e parashikuara në nenet 3, 4 dhe 5, të këtij akti normativ, detyrohen të njoftojnë, sipas rastit, respektivisht agjencinë/ transportuesin/akomoduesin ose organizatorin e paketave të udhëtimit/klientin për pamundësinë e zbatimit të kontratave të transportit, duke bashkëlidhur dokumentacionin që vërteton dokumentin e udhëtimit ose rezervimin e qëndrimit ose kontratat e paketave të udhëtimit.

2. Ky komunikim bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga:

a) hyrja në fuqi e këtij akti normativ, për shërbimet/kontratat, të cilave iu ka përfunduar afati;

b) data e planifikuar e nisjes apo e mbërritjes, për shërbimet/kontratat brenda afatit.

Neni 7

1. Operatorët turistikë apo/ose agjencitë e udhëtimit, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga komunikimi i përmendur në pikën 2, të nenit 6, të këtij akti normativ, të rimbursojnë dokumentin e udhëtimit dhe/ose paketën e udhëtimit nëpërmjet lëshimit të një kuponi (*voucher*), që korrespondon me të njëjtën vlerë/shumë totale që duhet të kthehet, duke i ofruar klientit mundësinë e përdorimit të kuponit për të njëjtin shërbim ose një të ngjashëm, që i përket kontratës së ndërprerë, e cila do të përdoret brenda 1 (një) viti.

2. Në rast se nuk realizohet shërbimi, sipas parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, operatorët turistikë apo/ose agjencitë e udhëtimit t'i rimbursojnë klientit vlerën/shumë totale të paguar.

Neni 8

1. Dispozitat e mësipërme zbatohen në rastet kur shërbimi i udhëtimit është objekt transaksioni nga/dhe agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë, vendas apo të huaj, që zhvillojnë veprimtarinë turistike sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ky akt normativ, në çdo rast, nuk ka për qëllim kufizimin e të drejtave dhe të lirive të subjekteve të përcaktuara në nenin 1, të këtij akti normativ.

Neni 9

Operatorët turistikë apo/ose agjencitë e udhëtimit, të cilët nuk e zbatojnë këtë akt normativ, përveç përmbushjes së detyrimeve kontraktuale ndaj klientit, dënohen me gjobë, për çdo kontratë të parealizuar, sipas masës së parashikuar në shkronjën "dh", të pikës 1, të nenit 71, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar.

Neni 10

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 452, datë 10.6.2020

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Albert Nikolla emërohet zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 454, datë 10.6.2020

PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT NR. 72/2019, "PËR MASAT SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, të neneve 6, pika 8, 10, pika 6, 15, pika 5, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën së Shqipërisë", dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për

bazat e të dhënave shtetërore", me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PROCEDURAT PËR BLLOKIMIN E PËRKOHSHËM

1. Ministria përgjegjëse për punët e jashtme, në vijim Ministria, me marrjen e njoftimit për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese të vendosura, sipas shkronjave "b", "c" dhe "ç", të pikës 3, të nenit 3, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", në vijim ligji nr. 72/2019, njofton menjëherë organet përgjegjëse.

2. Njoftimi i bëhet pikave të kontaktit, të caktuara nga organet përgjegjëse, nëpërmjet postës zyrtare elektronike.

3. Me marrjen e njoftimit, organet përgjegjëse marrin menjëherë masat për bllokimin e përkohshëm të aseteve që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, deri në miratimin e vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

4. Me marrjen e njoftimit për vendosjen, zbatimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, organet përgjegjëse, organet publike, si dhe çdo person, fizik ose juridik, në Republikën e Shqipërisë, janë të detyruara që të zbatojnë menjëherë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa e kushtëzuar procesin me miratimin e akteve të mëtejshme nënligjore brenda vendit, bllokimin e përkohshëm të çdo veprimi, ndërmjetësimi, transaksioni, transferte, shërbimi financiar apo të tjera të lidhura, fonde dhe pasuri të tjera.

5. Ministri përgjegjës për punët e jashtme, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni e vendosjes, ndryshimit apo shfuqizimit të masës shtrënguese në rastet e akteve të detyrueshme të miratuara nga organizata ndërkombëtare dhe rekomandimit të Komitetit të Masave Shtrënguese Ndërkombëtare për aktet të Bashkimit Evropian, i propozon Këshillit të Ministrave masën shtrënguese ndërkombëtare dhe subjektin ndaj të cilit vendoset kjo masë.

II. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMITETIT TË MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE

1. Komiteti i Masave Shtrënguese Ndërkombëtare, në vijim Komiteti, drejtohet nga ministri përgjegjës për punët e jashtme dhe, në mungesë të tij, nga zëvendësministri i deleguar prej tij.

2. Komiteti mblidhet, si më poshtë vijon:

2.1. Me kërkesë të ministrisë për të shqyrtuar:

a) kërkesën e organit përgjegjës drejtuar ministrisë, për rastet kur ky i fundit do të propozojë ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare me karakter të brendshëm. Kërkesa e organit përgjegjës drejtuar ministrisë duhet të jetë në përputhje me parashikimet e nenit 9, të ligjit nr. 72/2019.

b) njoftimet për masat shtrënguese të vendosura në bazë të:

i. akteve të detyrueshme, të miratuara nga organizatat ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është shtet anëtar, duke përjashtuar masat shtrënguese të vendosura nga OKB-ja;

ii. akteve të Bashkimit Evropian.

2.2 Me iniciativën e tij, për të përmbushur detyrat e përcaktuara në shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d", të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 72/2019.

3. Komiteti mblidhet pas marrjes së njoftimit, me shkrim, nga ministria. Njoftimi përmban rendin e ditës së mbledhjes, orën dhe datën, e cila duhet të jetë brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit.

4. Përveç rasteve kur mbledhja e Komitetit nuk ka objekt dhënien e rekomandimeve, Komiteti merr vendim për të dalë me një rekomandim, i cili do të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e tij.

5. Titullari i ministrisë ngarkon një nëpunës të strukturës përkatëse për organizatat ndërkombëtare si "pikë kontakti" për zbatimin e masave shtrënguese, sipas ligjit nr. 72/2019, i cili do të marrë pjesë në çdo mbledhje të Komitetit.

6. Me autorizim të ministrit përgjegjës për punët e jashtme, Komiteti mund të asistohet edhe nga një nëpunës i strukturës përkatëse që mbulon organizatën, e cila ka njoftuar për vendosjen ndryshimin dhe shfuqizimin e masës shtrënguese ndërkombëtare, si dhe një nëpunës nga struktura që do të përgatisë paketën ligjore për miratim në Këshillin e Ministrave të vendimit për vendosjen, ndryshimin ose shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare.

7. Dokumentacioni dhe materialet e përdoruara për mbledhjet e Komitetit arkivohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat.

III. KRIJIMI, PËRMBAJTJA, RREGULLAT E ADMINISTRIMIT E TË FUNKSIONIMIT, TË PËRDORIMIT DHE TË AKSESIMIT TË REGJISTRIT TË TË DHËNAVE PËR MASAT SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE

1. Në ministri krijohet regjistri elektronik i bazës Të të dhënave për masat shtrënguese ndërkombëtare.

2. Regjistri mbahet, ruhet, administrohet dhe përditësohet në formë elektronike nëpërmjet një sistemi kompjuterik nga nëpunësi i ngarkuar me autorizim të titullarit të ministrisë.

3. Regjistri përmban të dhëna të mbledhura nga burime autentike të krijimit të të dhënave nga ministria, si dhe të dhënat e ofruara nga organet përgjegjëse për:

a) subjektet të cilave u vendosen masa shtrënguese ndërkombëtare;

b) subjektet që shkelin zbatimin e masave shtrënguese, të vendosura sipas ligjit nr. 72/2019.

c) vendimet e gjykatës, nëse ka të tilla;

ç) kuadrin e masave shtrënguese ndërkombëtare.

4. Regjistrohen si të dhëna parësore në këtë bazë të dhënash elementet, si më poshtë vijon:

a) Autoriteti, i cili ka vendosur masën shtrënguese ndërkombëtare;

b) Parashtrimi i përmbledhur i rrethanave të faktit;

c) Arsyet për shkak të të cilave është vendosur masa shtrënguese ndërkombëtare;

ç) Dispozitivi i vendimit;

d) Data dhe vendi i marrjes së vendimit.

5. Regjistrohen si të dhëna dytësore në këtë bazë të dhënash:

a) të dhënat në lidhje me vendndodhjen e personit/subjektit;

b) të dhënat/gjenealitetet e subjektit ndaj të cilit është vendosur masa shtrënguese ndërkombëtare.

6. Regjistri aksesohet nga:

a) ministria, si administratore dhe përdoruese e regjistrit;

b) organet përgjegjëse zbatuese, si lexuese të regjistrit;

c) publiku, si lexues nëpërmjet ndërfaqes së ministrisë në internet dhe portalit qeveritar *e-Albania.*

6.1 Aksesi në këto të dhëna rregullohet sipas legjislacionit për të drejtën e informimit dhe legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Organet përgjegjëse, të përcaktuara në pikën 4, të nenit 10, të ligjit nr. 72/2019, i dërgojnë ministrisë pikat e kontaktit dhe funksionet e përfaqësuesve të Komitetit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Ngarkohen organet përgjegjëse të përcaktuara në nenin 11, të ligjit nr. 72/2019, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 455, datë 10.6.2020

PËR KRITERET DHE MASËN E KOMPENSIMIT TË QIRASË SË BANESËS DHE TË USHQIMIT TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura që, për shkak të detyrës, emërohet ose transferohet larg vendbanimit dhe nuk është trajtuar me banesë ose me kredi nga Ministria e Mbrojtjes dhe kur ai ose ndonjë pjesëtar i familjes nuk ka banesë në pronësi në vendin e punës, përfiton kompensim për qira banese deri në 3 (tre) vjet.

2. Masa e kompensimit të qirasë së banesës të jetë:

a) 70 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut, për qira banese, të tipit garsoniere, kur është beqar ose i martuar dhe pa fëmijë;

b) 70 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut, për qira banese, të tipit 1+1, kur është i martuar dhe ka një fëmijë;

c) 80 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut, për qira banese, të tipit 2+1, kur është i martuar dhe ka më shumë se një fëmijë.

3. Çmimi mesatar i qirasë së banesës përcaktohet çdo vit, me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe të ministrit të Mbrojtjes.

4. Ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura, që përfiton kompensim për qira banese, duhet të paraqesë pranë strukturës ushtarake përkatëse këto dokumente:

a) Kërkesën për kompensimin e qirasë së banesës;

b) Certifikatën personale, nëse nuk gjenerohet nga vetë struktura ushtarake;

c) Certifikatën familjare, nëse nuk gjenerohet nga vetë struktura ushtarake;

ç) Kontratën e qirasë së banesës, të noterizuar;

d) Vërtetimin përkatës se nuk është trajtuar me banesë apo me kredi nga Ministria e Mbrojtjes;

dh) Vërtetimin përkatës se ai/ajo ose pjesëtarët e familjes nuk kanë banesë në pronësi.

Këto dokumente rifreskohen çdo vit.

5. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura gëzojnë të drejtën e kompensimit financiar në vlerë në lekë, për trajtimin me ushqim vetëm për vaktin e drekës, sipas vendimit nr. 88, datë 28.1.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektivave ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", për ditët efektive të punës.

6. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, në rastet kur thirren në repart për nevoja shërbimi, ruajtjeje, gatishmërie, stërvitjeje ose fushimi mbi 8 orë, trajtohen me ushqim të gatuar ose kompensohen në vlerën në lekë të këtij ushqimi, aty ku nuk është i mundur ofrimi i këtij shërbimi, sipas normës së përcaktuar në vendimin nr. 88, datë 28.1.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektivave ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë".

7. Përzgjedhja e formës së trajtimit me ushqim ose e kompensimit në vlerë në lekë për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, sipas pikës 6, të këtij vendimi, përcaktohet me urdhër të ministrit të Mbrojtjes.

8. Masa e vlerës për kompensimin e ushqimit përcaktohet çdo vit me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, në bazë të kostos së ushqimit të gatuar dhe të vlerës kalorike të përcaktuar në vendimin nr. 88, datë 28.1.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektivave ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë".

9. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 524, datë 30.7.2004, "Për masën dhe mënyrën e kompensimit të qirasë së banesës dhe të ushqimit të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nr. 668, datë 7.8.2013, "Për trajtimin me ushqim të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 524, datë 30.7.2004 të Këshillit të Ministrave "Për masën dhe mënyrën e kompensimit të qirasë së banesës dhe të ushqimit të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", shfuqizohen.

10. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe ministria përgjegjëse për financat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 456, datë 10.6.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 910, DATË 21.12.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ÇËSHTJET, OBJEKT KONSULTIMI, DHE STRUKTURËN, PROCEDURËN, FORMËN, MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KONSULTATIV TË QEVERISJES QENDRORE ME VETËQEVERISJEN VENDORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 910, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në shkronjën "c", të pikës 4, pas nënndarjes "viii", "mbrojtjen e konsumatorëve" shtohet nënndarja "ix", me këtë përmbajtje:

"ix) diaspora dhe migracioni;".

2. Në pikën 7, të kreut III, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në fjalinë e parë, numri "9 (nëntë)" zëvendësohet me numrin "11 (njëmbëdhjetë)";

b) Pas nënndarjes "zëvendësministri përgjegjës për arsimin" shtohen nënndarjet, me këtë përmbajtje:

"- Përfaqësuesi i ministrit përgjegjës për marrëdhëniet me diasporën;

- Përfaqësuesi i ministrit përgjegjës për mbrojtjen e sipërmarrjes.".

c) Fjalët "... 2 kryetarë bashkie ..." zëvendësohen me "... 3 (tre) kryetarë bashkie ...".

II. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe ministri i Shtetit për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 457, datë 10.6.2020

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim parashikon mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (në vijim DPPPP), si person juridik, publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për financat (në vijim ministri), me seli në Tiranë. DPPPP-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Misioni i DPPPP-së është të sigurojë parandalimin e pastrimit të parave dhe të produkteve që burojnë nga veprat penale, si dhe parandalimin e financimit të terrorizmit, duke bashkëpunuar me institucionet/organet kompetente kombëtare e ndërkombëtare për të zbuluar dhe luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

3. DPPP-ja ka si fushë përgjegjësie:

a) parandalimin e pastrimit të parave dhe produkteve që burojnë nga veprat penale;

b) parandalimin e financimit të terrorizmit.

4. DPPP-ja ushtron funksionet e autoritetit përgjegjës, sipas legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe shërben si njësi e specializuar financiare për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE

DPPP-ja ka përgjegjësi të organizojë punën për:

a) ushtrimin e funksionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe produkteve që burojnë nga veprat penale;

b) ushtrimin e funksionit për parandalimin e financimit të terrorizmit;

c) mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit të të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE

1. DPPPP-ja e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror.

2. Struktura dhe organika e DPPPP-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

3. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të DPPPP-së miratohet nga ministri, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm.

4. DPPP-ja bashkëpunon me institucionet shtetërore dhe autoritetet e tjera kompetente të zbatimit të ligjit apo të inteligjencës, për çështjet e pastrimit të produkteve të veprës penale, veprat penale ose veprimtaritë kriminale, që gjenerojnë produktet e veprës penale dhe të financimit të terrorizimit. DPPP-ja mund të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi, dy ose shumëpalëshe, me këto institucione apo autoritete.

5. DPPPP-ja drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) drejton aktivitetin e DPPPP-së mbi bazën e legjislacionit në fuqi dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij;

b) informon në mënyrë periodike, me shkrim, për aktivitetin e DPPPP-së, Komitetin e Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave;

c) organizon dhe drejton analiza periodike të aktivitetit të DPPPP-së;

ç) krijon grupe pune për çështje specifike të punës së DPPPP-së dhe monitoron ecurinë e përmbushjes së qëllimit të tyre;

d) përfaqëson DPPPP-në në marrëdhënie me të tretët, brenda dhe jashtë vendit;

dh) miraton programe të kualifikimit profesional të punonjësve të DPPPP-së;

e) drejton dhe orienton punën e grupit teknik ndërinstitucional për parandalimin e pastrimit të parave, në kuadrin e Komitetit të Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave;

ë) merr vendim për kundërvajtjet administrative të kryera nga subjektet e legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;

f) raporton me shkrim te ministri përgjegjës dhe Kryeministri, sa herë që i kërkohet, por jo më pak se dy herë në vit;

g) është përgjegjës për ngritjen dhe zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në institucion, në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi;

gj) kryen çdo funksion tjetër si titullar institucioni, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Drejtori i përgjithshëm i DPPP-së emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të DPPP-së, përfshirë strukturën e teknologjisë së informacionit, rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

7. DPPPP-ja ka stemën, logon dhe vulën zyrtare. Stema e drejtorisë ka shënimet "Republika e Shqipërisë, Ministria e (emri i ministrisë përgjegjëse), "Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave", në përputhje me përcaktimin e vendimit të Këshillit të Ministrave, për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

8. Vula e DPPPP-së ka elementet dhe formën e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, të kontrollit dhe të ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Vendimi nr.922, datë 21.12.2011, i Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave", shfuqizohet.

2. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i DPPPP-së që, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të marrë masat për hartimin dhe paraqitjen e propozimit për miratimin e rregullores për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 458, datë 10.6.2020

PËR PËRCAKTIMIN E FAKTORËVE DHE TË SITUATAVE QË MERREN PARASYSH NË VLERËSIMIN E RREZIQEVE TË PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 4/2, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim përcakton faktorët tregues të situatave me risk të ulët të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, për të cilat mund të zbatohet vigjilenca e thjeshtuar.

2. Ky vendim zbatohet për vlerësimin e rreziqeve të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, që lidhen me llojin e klientëve, të zonës gjeografike, të produkteve, të shërbimeve, të transaksioneve apo të kanaleve të veçanta të shpërndarjes, në rastet e zbatimit të vigjilencës së thjeshtuar.

3. Faktorët tregues të riskut të ulët përfshijnë, si më poshtë vijon:

a) Faktorët e riskut që lidhen me klientin:

i. kompanitë publike të listuara në tregje titujsh dhe që u nënshtrohen rregullave të transparencës (sipas rregullave të tregut të titujve apo nëpërmjet ligjit apo të mjeteve të tjera të detyrueshme), që vendosin rregulla për transparencën e pronarëve përfitues;

ii. ndërmarrjet apo administratat publike.

b) Faktorët e riskut që lidhen me produktet, transaksionet, shërbimet apo kanalet e shpërndarjes janë:

i. policat e sigurimit të jetës me prim të ulët;

ii. policat e sigurimit në skemat e pensionit pa mundësi përfitimi të parakohshëm dhe polica nuk mund të përdoret si kolateral;

iii. skemat e pensionit të zakonshëm, të pensionit suplementar apo të përfitimeve të tjera të ngjashme, të cilat sigurojnë përfitime për punonjësit pas daljes në pension, kur kontributet zbriten nga paga dhe rregullat e skemës së pensionit nuk lejojnë transferimin e së drejtës;

iv. shërbime apo produkte financiare, të cilat sigurojnë shërbime të kufizuara dhe të përcaktuara shprehimisht për kategori të caktuara klientësh, me qëllim përfshirjeje financiare;

v. produkte ku risqet e pastrimit të parave apo të financimit të terrorizmit menaxhohen nga faktorë të tjerë.

c) Faktorët gjeografikë të riskut janë:

i. vendet e vlerësuara si vende me sisteme efektive kundër pastrimit të parave apo të financimit të terrorizmit;

ii. vende të identifikuara, nga burime të besueshme, si vende me nivele të ulëta të korrupsionit apo të veprimtarive të tjera kriminale;

iii. vende, të cilat, sipas burimeve të besueshme, si raporte të përbashkëta të vlerësimit, raporte të hollësishme të vlerësimit apo raporte të publikuara të vëzhgimit, kanë kërkesa për luftimin e pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit, në përputhje me rekomandimet e rishikuara të grupit të posaçëm të veprimit financiar dhe i zbatojnë efektivisht ato kërkesa.

4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, autoritetet mbikëqyrëse e licencuese, si dhe subjektet raportuese për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 460, datë 10.6.2020

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DHE QEVERISË SË KONFEDERATËS ZVICERANE, PËRFAQËSUAR NGA SEKRETARIATI I SHTETIT PËR ÇËSHTJET EKONOMIKE, LIDHUR ME OFRIMIN E NDIHMËS TEKNIKE DHE FINANCIARE PËR PROJEKTIN "MENAXHIMI I MBETJEVE TË NGURTA NË QARKUN E BERATIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike, lidhur me ofrimin e ndihmës teknike dhe financiare për projektin "Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Qarkun e Beratit", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE

NDËRMJET KONFEDERATËS ZVICERANE PËRFAQËSUAR NGA SEKRETARIATI I SHTETIT PËR ÇËSHTJET EKONOMIKE I DEPARTAMENTIT FEDERAL PËR ÇËSHTJET EKONOMIKE, ARSIMORE DHE KËRKIMORE
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBI OFRIMIN E NDIHMËS TEKNIKE DHE FINANCIARE PËR PROJEKTIN "MENAXHIMI I MBETJEVE TË NGURTA NË QARKUN E BERATIT"

Konfederata Zvicerane dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë,

DUKE IU REFERUAR marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për bashkëpunimin Teknik, Financiar dhe Humanitar, lidhur dhe nënshkruar në Tiranë më 11 Maj 2007 dhe ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr. 9801, datë 13 shtator 2007,

ME DËSHIRËN për të përforcuar këto marrëdhënie miqësore dhe bashkëpunimin e frytshëm midis dy vendeve,

ME SYNIM nxitjen e zhvillimit të mëtejshëm ekonomik dhe shoqëror të Republikës së Shqipërisë,

DUKE NJOHUR përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për të vazhduar reformat në mënyrë që të krijojë një ekonomi tregu sipas kushteve demokratike, dhe për të ofruar një mjedis të shëndetshëm dhe të përshtatshëm ekologjikisht për brezat aktualë dhe të ardhshëm,

DUKE PRANUAR se programi është bazuar në objektivat e zhvillimit të sipërmarrjes dhe të sektorit privat, dhe të krijimit të vendeve të punës, të shprehura në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020 dhe Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të mbetjeve dhe Plan Veprimin 2012 – 2025,

DUKE MARRË NË KONSIDERATË ofrimin e ndihmës teknike dhe financiare për Projektin "Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta në Qarkun e Beratit"

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1 Përkufizime

Në këtë projekt marrëveshje,përveç rasteve kur konteksti kërkon ndryshe, Termat në vijim kanë kuptimin si më poshtë:

a. "Qeveria e Republikës së Shqipërisë" nënkupton Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministra e Mjedisit, Ministra e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Zhvillimit Urban;

b. "Konfederata Zvicerane" nënkupton Qeverinë e Konfederatës Zvicerane (Këshillin Federal Zviceran), të përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike;

c. "MM" nënkupton Ministrinë e Mjedisit të Republikës së Shqipërisë;

d. "MTI" nënkupton Ministrinë e Transporteve dhe Infrastrukturës të Republikës së Shqipërisë;

e. "MZHU" nënkupton Ministrinë e Zhvillimit Urban të Republikës së Shqipërisë;

f. "SECO" nënkupton Sekretariatin e Shtetit për Çështjet Ekonomike të Konfederatës Zvicerane "SECO";

g. "Palët Kontraktuese" nënkupton Qeverinë e Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane;

h. "Marrëveshja Kuadër " nënkupton Marrëveshjen midis Këshillit Federal Zviceran dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik, Financiar dhe Humanitar lidhur dhe nënshkruar më 11 maj 2007 dhe e ratifikuar nga

Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr. 9801, datë 13 shtator 2007;

i. "Projekti" nënkupton menaxhimin e mbetjeve të ngurta në Qarkun e Beratit;

j. "Marrëveshja e Projektit" nënkupton këtë marrëveshje, e cila përcakton të drejtat dhe Detyrimet e Palëve Kontraktuese në lidhje me Projektin, në vijim referuar gjithashtu si MP;

k. "NJKP" nënkupton Njësinë e Koordinimit të Projektit (NJKP) në Bashkinë e Beratit, përgjegjëse për të gjithë koordinimin e të gjitha veprimtarive administrative;

l. "Konsulentët" nënkupton grupin e ekspertëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë që kanë ekspertizë specifike në menaxhimin e mbetjeve të ngurta, ngritjen e kapaciteteve që do të ofrojnë shërbimet e këshillimit dhe ngritjes së kapaciteteve të nevojshme për të gjithë komponentët e projektit. Gjithashtu grupi është përgjegjës për zbatimin e Projektimit dhe Zbatimit të Masave Afat-Shkurtra;

m. "Furnitori" nënkupton kontraktorin që do të ofrojë punimet dhe materialet për realizimin e masave afat-shkurtra;

n. "Kontribut" nënkupton kontributin financiar të parimbursueshëm të lëvruar nga SECO sipas MP;

o. "Politikat e Auditimit Financiar të SECO" nënkupton udhëzimet për auditime lidhur me projektet e financuara nga SECO;

p. "Masat Afat-Shkurtra" nënkupton masat e marra në kuadër të Projektit që përqendrohen në prekshmëri të lartë dhe rritjen e ndërgjegjësimit mes vendimmarrësve dhe qytetarëve të Qarkut të Beratit. Masat mund të përfshijnë blerjen e pajisjeve për mbetjet e vogla, si kazanët ndarës, kontenierët, pajisjet e riciklimit ose uniformat e nëpunësve civilë, si dhe masat e veçanta për rehabilitimin mjedisor; dhe

q. "TVSH" nënkupton taksën mbi vlerën e shtuar.

Neni 2 Objektivi dhe Qëllimi i Projektit

2.1 Objektivi i përgjithshëm i projektit është të përmirësojë cilësinë, besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve në Qarkun/Rajonin e Beratit dhe të reduktojë ndikimin negativ në mjedis e mbetjeve të prodhuara. Projekti do të nxisë ndërgjegjësimin e vendimmarrësve politik, nëpunësve civilë dhe publikut për çështjet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe mbështetjen për zbatimin e legjislacionit përkatës. Projekti do të zhvillojë kapacitet e përgjithshme të autoriteteve publike për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, por në veçanti do të nxisë aftësitë për hartimin e politikave dhe skemave të financimit për përmirësimin e shërbimeve. Projekti do të hedhë bazat për investimet e ardhshme të qëndrueshme infrastrukturore.

Ndikimi i parashikuar i Projektit mund të përshkruhet si më poshtë:

231,163 qytetarë të rajonit të Beratit do të jetojnë në Bashki të pastra dhe me kushte të përmirësuara higjienike, do të shijojnë përmirësimin e cilësisë së jetesës, shëndetit dhe rritjen e veprimtarive të biznesit. Për referencë është bashkëngjitur një kuadër logjik në shtojcën 2 të MP.

Projekti përfshin katër komponentë:

1) Mbështetjen për Zhvillimit Institucional dhe të Kapaciteteve,
2) Rishikimin e Planit Rajonal për Menaxhimin e Mbetjeve dhe përgatitjen e Studimit të Fizibilitetit që synon Masat e ardhshme Rajonale të Investimit,
3) Rritja e Ndërgjegjësimit dhe Informimi i Publikut,
4) Hartimi dhe Zbatimi i Masave Afat Shkurtra.

Një përshkrim i detajuar është bashkëngjitur në Shtojcën 1. Plani i projektit është pasqyruar në Shtojcën 3.

2.2 Progresi i projektit do të monitorohet duke krijuar një bazë matëse bazuar në veprimtaritë e menaxhimit të mbetjeve të ngurta të bashkive me treguesit përkatës.

2.3 Projekti hedh bazat për t'u ndjekur nga një projekt i II-të i mundshëm, përqendruar në zbatimin e Planit për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta të Qarkut (bazuar në studimin e fizibilitetit për Masat e Investimeve Rajonale të përpunuar në hapin e parë). Projekti i mundshëm II do të përfshijë njëkohësisht, realizimin e Masave të Investimeve në Qark si, stacionet e transferimit, mjetet e transportit, impiantet e trajtimit apo landfilli higjienik, si dhe mbështetjen institucionale për veprimtarinë e qëndrueshme të impianteve. Projekti i mundshëm II nuk është temë e kësaj MP-je.

Neni 3 Shuma dhe Përdorimi i Kontributit

3.1 SECO bie dakord të vërë në dispozicion një Kontribut të parimbursueshëm në vlerën maksimale prej 2'200'000 CHF (dy milion e dyqind mijë franga zvicerane) për zbatimin e Projektit. Për Referencë, buxheti është bashkëngjitur në Shtojcën 4.

3.2 Kontributi është në varësi të miratimit të lëvrimit të kreditit vjetor për SECO-n nga Parlamenti Federal i Zvicrës.

3.3 Bashkitë Berat, Kuçovë, Ura Vajgurore, Poliçan dhe Skrapar do të kontribuojnë në total 200'000 CHF (dyqind mijë franga zvicerane).

3.4 Ndarja e kontributit prej 200'000 CHF (dyqind mijë franga zvicerane) të bashkive Berat, Kuçovë, Ura Vajgurore, Poliçan dhe Skrapar bazohet në numrin aktual të banorëve në këto bashki 231,136[1]:

Bashkia	Banorë	Kontributi Financiar
Berat	99,231	CHF 86'000
Kuçovë	55,536	CHF 48'000
Ura Vajgurore	39,819	CHF 34'500
Poliçan	18,146	CHF 15'500
Skrapar	18,431	CHF 16'000

3.5 Kontributi financiar i bashkive Berat, Kuçovë, Ura Vajgurore, Poliçan dhe Skrapar do të përdoret për Masat Afat Shkurtra në juridiksionet e tyre bashkiake.

[1] Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në lidhje me listen e numrit të popullsisë, datë 01.01.2016.

3.6 Fondet e emergjencës, përcaktuar në Shtojcën 4, do të përdoren në rast të shpenzimeve të paparashikuara që mund të lindin gjatë zbatimit të projektit dhe për veprimtari të lidhura me Projektin që konsiderohen të domosdoshme nga SECO për zbatimin e suksesshëm të Projektit. Vendimi për përdorimin e zërit të fondeve të emergjencës merret nën gjykimin e plotë të SECO-s.

3.7 Asnjë e ardhur nga Kontributi nuk përdoret për veprimtari të tjera përveç atyre të parashikuara në Projekt.

3.8 Asnjë e ardhur nga Kontributi nuk përdoret për pagesa të detyrimeve apo tatimeve si TVSH, detyrime doganore dhe tarifa importi, të përcaktuara sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë ose entiteteve në varësi të Shtetit.

3.9 Pjesa e papërdorur e kontributit e mbetur pas përmbushjes së detyrimeve, përkatësisht pas përfundimit të MP-së sipas nenit 12 anulohet, përveç rasteve kur palët kontraktuese bien dakord për të vepruar ndryshe.

Neni 4 Kushtet e Kontributit

4.1 Angazhimi i MM, MTI, MZHU dhe Bashkive të Beratit, Kuçovës, Urës Vajgurore, Poliçanit dhe Skrapar është faktor kyç për suksesin e Projektit.

4.2 Projekti ka dy etapa:

Së pari, Studimi i Fizibilitetit për Masat Rajonale të Investimit në të ardhmen do të nisë vetëm kur Plani i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta të jetë përfunduar dhe të miratuar nga Këshilli i Qarkut Berat.

Së dyti, Masat Afat Shkurtra për çdo bashki do të zbatohen vetëm kur bashkitë përkatëse të kenë konfirmuar kontributin financiar përfundimtar sipas Nenit 3.3.

4.3 Nëse MP nuk përmban dispozita të veçanta që nuk janë parashikuar në Marrëveshjen Kuadër, dispozitat e Marrëveshjes Kuadër zbatohen plotësisht. Në veçanti, Qeveria e Republikës së Shqipërisë siguron kushtet e zbatimit të Projektit sipas nenit 4 të Marrëveshjes Kuadër.

4.4 Qeveria e Shqipërisë siguron menjëherë, dhe pa pengesa administrative, stafit ndërkombëtar të Konsulentit dhe Furnitorit dhe çdo eksperti tjetër të huaj të përfshirë në Projekt, vizat e nevojshme hyrëse pa pagesë, si dhe përjashtimin nga të gjitha detyrimet doganore, tatime apo detyrime të tjera të parashikuara në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë apo të ndonjë institucioni në varësi të Shtetit, që lidhet me pagat, sendet personale dhe pajisjet e nevojshme për detyrat e tyre në këtë Projekt.

4.5 MTI lehtëson importimin e përkohshëm në dhe ri-eksportimin vijues nga Shqipëria të të gjitha pajisjeve të nevojshme në pronësi të Konsulentit, Furnitorit dhe të ekspertëve të tjerë të huaj që lidhen me ofrimin e shërbimeve të tyre.

4.6 Qeveria e Republikës së Shqipërisë ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar akses të plotë dhe të shpejtë për personat e përfshirë në këtë Projekt në informacionin teknik dhe institucional të nevojshëm.

4.7 Për të siguruar bërjen publike të Kontributit, të gjitha materialet e marrëdhënieve me publikun dhe të gjitha dokumentet e përgatitura në kuadër të Projektit duhet të përmendin faktin se Projekti është financuar nga Konfederata Zvicerane dhe të shfaqin logon e Konfederatës Zvicerane.

4.8 MTI mundëson buxhetin e nevojshëm për të garantuar rimbursimin e shpenzimeve të Projektit të lidhura me TVSH-në në një vlerë të përafërt prej 400'000 CHF (katërqind mijë franga zvicerane) gjatë zbatimit të projektit, që pritet në periudhën 2017-2019.

Neni 5 Organizimi i Projektit dhe Përgjegjësia

Roli i MM, MTI dhe MZHU

5.1 MM, MTI dhe MZHU ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e Projektit; bashkërenduar partnerët zbatues me autoritetet qeveritare të përfshira në veprimtaritë e Projektit; ofruar akses në informacione të rëndësishme, përfshirë të dhëna statistikore që konsiderohen të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektivave të Projektit. Informacioni përdoret vetëm për qëllimet e Projektit. Çdo përdorim tjetër merr pëlqimin paraprak me shkrim të MM, MTI dhe MZHU.

Roli i Bashkive dhe Administratës së Qarkut të Beratit

5.2.1 Partnerët e drejtpërdrejtë të Projektit, ose ndryshe agjencitë e zbatimit të Projektit janë pesë bashkitë e Beratit, Skraparit, Kuçovës, Poliçanit dhe Urës Vajgurore, të cilat kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në territorin e bashkisë përkatëse dhe për zbatimin e Projektit. Bashkitë ndërmarrin ose nxisin ndërmarrjen e të gjitha veprime të nevojshme për të krijuar një mjedis të favorshëm për përforcimin e Projektit.

5.2.2 Bashkitë duket të sigurojnë që nëpunësit civil që janë përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në administratën e Bashkisë të jenë të gatshëm të marrin pjesë në Projekt dhe të përmbushin detyrat që rrjedhin nga Projekti brenda afateve të caktuara.

5.2.3 Në Bashkinë e Beratit ngrihet një NJKP për bashkërendimin e të gjitha veprimtaritë administrative të Projektit.

5.2.4 Në nivel Qarku, Projekti bashkëpunon me administratën e Qarkut të Beratit, veçanërisht për diskutim dhe vendimmarrje në lidhje konceptet rajonale dhe Masave për Investimet Rajonale.

Roli i Konsulentit

5.3.1 Pas përfundimit të procesit të tenderimit, Konfederata Zvicerane përcakton Konsulentin për Projektin dhe lidh me të kontratën përkatëse për zbatim. Konsulenti është përgjegjës për zbatimin e Projektit dhe merr përsipër të gjitha detyrat administrative dhe mbikëqyrëse të Projektit, përfshirë monitorimin dhe raportimin.

5.3.2 Konsulenti do të punojë nga afër me Bashkitë e Beratit, Skraparit, Kuçovës, Poliçanit dhe Urës Vajgurore, shoqërinë civile dhe sektorin privat.

5.3.3 Krijohet një grup pune i Projektit, i përbërë nga ekspertë teknikë nga të pesë bashkitë për të përgatitur vendimet teknike dhe politike, bashkërendimin dhe komunikimin e veprimtarive operacionale të Projektit.

Roli i SECO

5.4 SECO është autoriteti përgjegjës në emër të Konfederatës Zvicerane dhe:

- ofron Kontribut të pa-rimbursueshëm sipas përcaktimeve të Nenit 3;
- monitoron përmbushjen e etapave të Projektit;
- kontrakton Konsulentin për zbatimin e Projektit;
- kontrakton Furnitorin(ët) e Projektit, financuar nga kontributi Zviceran;
- kryen në kohë pagesat për Konsulentin dhe Furnitorin(ët) e Projektit, pas miratimit me shkrim të palëve përgjegjëse sipas parashikimeve të Nenit 6.

Roli i Ambasadës Zvicerane

5.5 Ambasada Zvicerane përfaqëson SECO-n në Projekt dhe:

- mbikëqyr Projektin dhe ndjek nga afër zhvillimet në sektorin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta;
- përfaqëson SECO-n në Komitetin Drejtues.

Komiteti Drejtues

5.6 Komiteti Drejtues, i përbërë nga Kryetari i Qarkut Berat, kryetarët e pesë bashkive apo nën kryetarët e pesë bashkive, dhe një përfaqësues nga MTI, MM, MZHU dhe Ambasada e Zvicrës në Tiranë, të mbështetur nga menaxheri i programit të SECO, ofron orientim strategjik dhe mbështetje për zbatimin me sukses të veprimtarive të Projektit dhe arritjen e rezultateve të pritshme, si dhe të siguron transparencë dhe mbështet pronësinë e palëve të interesuara.

Neni 6 Prokurimi dhe Kontratat

6.1 Prokurimet lidhur me kontributin e SECO-s

6.1.1 Prokurimi për Konsulentin do të realizohet nga SECO në përputhje me të drejtën zvicerane për tenderimin me procedurë të hapur. Kontrata e Konsulentit do të lidhet midis SECO-s dhe Konsulentit. Bashkitë e Beratit, Skraparit, Kuçovës, Poliçanit dhe Urës Vajgurore do të konsultohen në lidhje me Termat e Referencës për Konsulentin. Pagesa e Konsulentit kryhet drejtpërsëdrejti nga SECO. SECO miraton drejtpërsëdrejti faturat dhe lëvron pagesat.

6.1.2 Prokurimi për Masat Afat Shkurtra bëhet nga SECO në përputhje me të drejtën zvicerane për tenderimin me procedurë të hapur. Kontratat do të lidhen mes SECO-s dhe Furnitorit(ëve). Bashkitë e përfshira kanë klauzolën e mos-kundërshtimit në Termat e Referencës për Furnitorin(ët). Furnitorët paguhen drejtpërsëdrejti nga SECO pas marrjes së miratimit me shkrim nga Konsulenti.

6.2 Prokurimi në lidhje me kontributet e Bashkive Berat, Kuçovë, Ura Vajgurore, Poliçan dhe Skrapar

6.2.1 Masat Afat Shkurtra që drejtohen vetëm tek bashkitë e veçanta prokurohen nga bashkia përkatëse në përputhje me rregullat shqiptare për tenderim me procedurë të hapur. Kontrata do të lidhet ndërmjet bashkisë përkatëse dhe Furnitorit(ëve). Konsulenti shqyrton dhe komenton Termat e Referencës për Furnitorin(ët). SECO ka të drejtën e mos-kundërshtisë në lidhje me nënshkrimin e kontratës dhe ndryshimet e saj. Furnitori(ët) paguhen drejtpërdrejtë nga bashkitë.

6.2.2 Për kontratat e punimeve dhe mallrave për Masat Afat Shkurtra nën 50.000 CHF që lidhen vetëm me një bashki, mund të aplikohet procedura e ftesës për tenderim ose procedura direkte. Kontrata lidhet ndërmjet bashkisë përkatëse dhe Furnitorit(ëve). Kontrata që lidhet ndërmjet bashkisë përkatëse dhe Furnitorit(ëve) është në përputhje me rregullat shqiptare. Konsulenti shqyrton dhe komenton Termat e Referencës për Furnitorin(ët). SECO ka të drejtën e mos-kundërshtisë në lidhje me nënshkrimin e kontratës dhe ndryshimet e saj. Furnitori(ët) paguhen drejtpërdrejtë nga bashkitë.

6.3 Klauzolat e përgjithshme të Prokurimit

6.3.1 Procedurat e apelimit (përkatësisht Ligji Federal Zviceran për Prokurimin Publik APP & Urdhëresa për Prokurimin Publik OPP) nuk zbatohen. E drejta për kompensim përjashtohet.

6.3.2 Gjatë kohëzgjatjes së Projektit, të mirat e siguruara me fondet e SECO-s në përdorim të Projektit qëndrojnë në dispozicion të pakufizuar të Projektit dhe nuk duhet të përdoren për qëllime të tjera jashtë Projektit pa miratimin paraprak me shkrim të SECO-s.

6.3.3 Nëse për ndonjë arsye Projekti ndërpritet, përdorimi i të mirave siguruar me kontributin zviceran do të menaxhohet sipas vendimeve të SECO-s. Në përfundim të Projektit, SECO vendos për pronësinë dhe përdorimin e të mirave që janë prokuruar për Projektin.

6.4 Auditi Financiar dhe Vlerësimi i Projektit

6.4.1 Audituesit financiar kontraktohen nga SECO. Kontrata lidhet midis SECO-s dhe audituesve të zgjedhur. SECO miraton drejtpërsëdrejti faturat dhe pagesat. Për auditin financiar të jashtëm është parashikuar një buxhet prej 20.000 CHF.

6.4.2 Nëse është e nevojshme, në përfundim të Projektit, SECO do të caktojë ekspertë për të kryer një studim vlerësues. Kontrata për vlerësimin fakultativ prokurohet nga SECO në përputhje me udhëzimet për prokurimet të SECO-s. Kontrata lidhet midis SECO-s dhe ekspertëve të përzgjedhur. Faturat dhe pagesat miratohen drejtpërsëdrejti nga SECO. Buxheti i parashikuar për studimin e vlerësimit fakultativ në përfundim të Projektit është 50.000 CHF.

Neni 7 Zbatimi i Projektit

7.1 Në përputhje me parimin udhëheqës të Projektit, pjesëtarët e të gjitha organeve të përfshira gjithmonë përpiqen të veprojnë në frymën e bashkëpunimit dhe marrin vendime në konsensus. Nëse dhe kur lind nevoja, Palët Kontraktuese me kërkesë të Palëve:

(a) shkëmbejnë këndvështrimet më lidhje me përmbushjen e detyrimeve përkatëse sipas MP-së, administrimin e Kontributit dhe veprimet e financuara nga Kontributi;

(b) i mundësojnë Palës tjetër Kontraktuese informacionin e kërkuar në mënyrë të arsyeshme për ekzekutimin e Kontributit dhe veprimtarive të financuara nga Kontributi.

7.2 Palët Kontraktuese informojnë menjëherë njëra-tjetrën për çdo rrethanë që ndërhyn apo kërcënon të ndërhyjë në arritjen e qëllimit të Kontributit ose në performancën dhe detyrimet e secilit prej tyre sipas MP-së.

7.3 Secila nga Palët Kontraktuese ruan të dhëna dhe procesverbale në lidhje me zbatimin e Projektit dhe përdorimit të Kontributit. Ato gjithashtu ruajnë të gjithë dokumentacionin në lidhje me MP-në dhe zbatimin e saj për dhjetë vjet pas përfundimit të Projektit.

7.4 Në përfundim të Projektit ndërmerret auditi financiar në përputhje me Politikën e Auditimit Financiar të SECO. (shih nenin 6.4).

7.5 SECO mund të organizojë misione shqyrtimi në çdo kohë, për të siguruar zbatimin efikas të Projektit dhe përdorimin e Kontributit dhe gjithashtu realizimin e objektivave të tij.

7.6 Pas përfundimit të Projektit, por jo më vonë se katër muaj pas përmbylljes së MP-së, NJKP-ja i dorëzon SECO-s një raport me fushëveprim dhe detaje bazuar në kërkesat e arsyeshme të SECO-s në lidhje me ekzekutimin e Projektit dhe përmbushjen e qëllimit të Kontributit.

Neni 8 Klauzola Anti-korrupsion

Palët Kontraktuese ndajnë të njëjtin shqetësim në luftën kundër korrupsionit, i cili vë në rrezik qeverisjen e mirë dhe përdorimin e duhur të burimeve të nevojshme për zhvillim, dhe për më tepër rrezikon konkurrencën e drejtë dhe të hapur të bazuar në çmim dhe cilësi. Si rrjedhojë, ato deklarojnë qëllimin e tyre për të bashkuar përpjekjet e tyre për të luftuar korrupsionin, dhe në veçanti deklarojnë që çdo ofertë, dhuratë, pagesë, shpërblim apo përfitim i çdo lloji, i dhënë nga kushdo, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me synimin për të marrë një mandat apo kontratë brenda kuadrit të MP-së, ose gjatë zbatimit të saj, do të përbëjë një veprim të paligjshëm ose praktikë korrupsioni. Çdo veprim i kësaj natyre përbën arsye të mjaftueshme për të justifikuar ndërprerjen e MP-së, prokurimit ose të lidhjes së kontratës që vjen si rrjedhojë, ose për të marrë ndonjë masë tjetër korrigjuese të parashikuar nga legjislacioni i zbatueshëm.

Palët duhet ta njoftojnë njëra-tjetrën menjëherë për ndonjë dyshim të mirë bazuar për korrupsion.

Neni 9 Bazat e Bashkëpunimit

Respekti i parimeve demokratike dhe i të drejtave themelore të njeriut, specifikuar veçanti në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut është baza e politikave të brendshme të Palëve Kontraktuese dhe ai përfaqëson një element thelbësor po aq të rëndësishëm sa objektivat e MP-së.

Neni 10 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Në rast të ndonjë mosmarrëveshje nga interpretimi apo zbatimi i dispozitave të MP-së, Palët Kontraktuese i zgjidhin ato nëpërmjet të negociatave diplomatike.

Neni 11 Modifikime ose Ndryshime, Shtojcat

11.1 Çdo modifikim i apo ndryshim në MP-së i bërë nga Palët Kontraktuese të kësaj MP-je bëhet vetëm me shkrim dhe siç është rënë dakord me konsensus midis Palëve Kontraktuese.

11.2 Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e kësaj MP-je:

11.2.1. Shtojca 1: Përshkrimi i Projektit
11.2.2. Shtojca 2: Kuadri Logjik
11.2.3. Shtojca 3: Plan Projekti
11.2.4. Shtojca 4: Buxheti i Projektit

Neni 12 Hyrja në Fuqi dhe Përfundimi

12.1 MP-ja hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Palët dhe pasi të merret njoftimi përkatës nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ku të shprehet se ka përmbushur të gjithë procedurat e brendshme ligjore të përcaktuara nga kuadri përkatës ligjor në fuqi. MP-ja mbetet në fuqi derisa të gjitha detyrimet e saj të jenë përmbushur, por jo më vonë se 31 dhjetor 2020.

12.2 Secila palë ka të drejtë të pezullojë ose të ndërpresë MP-në në çdo kohë, duke dhënë një njoftim me shkrim gjashtë muaj përpara. Pavarësisht nga sa më sipër, çdo njëra nga Palët, me njoftim me shkrim, mund të ndërpresë MP-në aktuale me efekt të menjëhershëm në rast të ndonjë shkelje domethënëse të MP-së. Shkelje domethënëse nënkupton çdo shkelje të rëndë të njërit prej objektivave të thelbësorë të MP-së apo shkelje e rëndë e detyrimeve të Palëve Kontraktuese.

12.3 Në rast të ndërprerjes së MP-së sipas Nenit 12, pika 2, dispozitat e MP-së vazhdojnë të zbatohen për të gjitha kontratat që janë në vazhdim në kohën e ndërprerjes së saj, derisa kontratat përkatëse të jenë përmbyllur.

Neni 13 Baza Ligjore

Marrëveshja Kuadër dhe Udhëzimet për Prokurimet të SECO janë pjesë përbërëse e MP-së. Në rast mospërputhje në përmbajtje MP-ja mbizotëron. E Drejta Nënligjore Zvicerane është e aplikueshme.

Neni 14 Gjuha

E gjithë korrespondenca me SECO-n përfshirë çdo lloj dokumenti, miratim faturash, raporte dhe dokumente të tjerë në lidhje me Projektin përpilohet në gjuhën angleze.

Neni 15 Përgjegjësitë

SECO nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi apo detyrim për dëme, dëmtime apo rezultate të tjera të mundshme negative të shkaktuara nga Projekti, përfshirë por jo të kufizuara në mospërputhjet e planifikimit të Projektit apo Projekteve të tjera që mund të ndikojnë mbi të, apo të shkaktojnë pakënaqësi tek publiku.

***

Hartuar në Tiranë më 1 nëntor 2017 në shtatë kopje origjinale në gjuhën angleze dhe shqipe. Në rast mospërputhje në interpretimin apo zbatimin e dispozitave të kësaj MP-i, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

Në emër të Konfederatës Zvicerane

.....

Christoph Graf

Ambasador
Ambasada e Zvicrës në Shqipëri

Në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë

.....

Damian Gjiknuri

Ministër
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Dëshmuar nga:

Për Bashkinë e Beratit

.....

Petrit Sinaj
Kryetar i Bashkisë

Për Bashkinë e Kuçovës

.....

Selfo Kapllani
Kryetar i Bashkisë

Për Bashkinë e Urës Vajgurore

.....

Juliana Memaj
Kryetare e Bashkisë

Për Bashkinë e Poliçanit

.....

Adriatik Zotkaj
Kryetar i Bashkisë

Për Bashkinë e Skraparit

.....

Nesim Spahiu
Kryetar i Bashkisë

Shtojca 1: Përshkrimi i Projektit

Objektivi

Projekti i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta (MMN) do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë, sigurisë dhe qëndrueshmërisë së menaxhimit të shërbimeve të mbetjeve në qarkun e Beratit dhe do të reduktojë ndikimin mjedisor të mbetjeve të prodhuara. Do të nxisë ndërgjegjësimin e vendimmarrësve politikë, nëpunësve civilë dhe publikut në çështje e MMN-së dhe do të mbështesë zbatimin e rregullave përkatëse. Projekti do të zhvillojë aftësitë e përgjithshme të autoriteteve të MMN-së, por gjithashtu do të mbështesë aftësitë për hartimin e politikave dhe skemave të financimit për përmirësimin e shërbimeve.

Ndikimi i pritshëm i Projektit mund të përshkruhet si vijon: 231,163 qytetarët e qarkut të Beratit me kushtet e reja higjienike jetojnë në bashki me të pastra, shijojnë përmirësimin e cilësisë së jetesës, shëndetit dhe shtimin e veprimtarive të biznesit.

Veprimtaritë dhe rezultatet e pritura

Projekti nis me një fazë fillestare që do të mbulojë veprimtaritë e mëposhtme: Analiza e grupeve të interesit, analiza e gjendjes dhe diagnostikimi i sektorit të MMN-së, verifikimi i instrumenteve të monitorimit, përfshirë kuadrin logjik, përcaktimin e bazës fillestare dhe vlerave të synuara për treguesit matës dhe identifikimin e Masave Afat Shkurtra (në kuadrin e komponentit të 4-t).

Projekti ka **katër komponentë**:

1. **Komponenti i parë: Mbështetja për zhvillimin institucional dhe ngritjen e kapaciteteve**

   Përmes komponentit 1, Qeverisjes së Qarkut të Beratit dhe bashkive do t'i mundësohet mbështetje e vazhdueshme për zhvillim institucional dhe ngritje kapacitetesh me qëllimin zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme dhe për mundësimin e instrumenteve të përshtatshëm për zbatimin dhe operacionet e qëndrueshme të sistemit të ardhshëm të përmirësuar të MMN-së. Mbështetja institucionale do të përqendrohet së pari në zbatimin e masave organizative dhe financiare[8] të konceptit MMN (shtjelluar në komponentin 2), paraqitjen e dhe trajnimin në lidhje me instrumentet përkatëse të monitorimit dhe zbatimin e strukturave dhe procedurave të përshtatshme për një MMN efikas në Qarkun e Beratit. Mbështetja për zhvillimin e kapaciteteve do të përqendrohet në realizimin e vlerësimit të nevojave për kapacitete, hartimin e strategjisë për zhvillimin e kapaciteteve dhe më pas zbatimin e masave specifike për zhvillimin të kapaciteteve.

   Rezultati i komponentit 1: Sektori i MMN-së i Bashkisë dhe stafi i tyre do të jetë në gjendje të planifikojnë dhe të ofrojnë shërbime të përmirësuara dhe më të qëndrueshme të MMN-së në zonat aktuale dhe mundësisht në ato rurale.

2. **Komponenti i dytë: Përgatitja e Planit Rajonal të MMN dhe studimi i fizibilitetit:**

   Objektivi i parë i komponentit 2 është hartimi i planit të MMN-së ku pasqyrohen të gjithë elementët e nevojshëm për ngritjen e një sistemi të integruar MMN në Qarkun e Beratit. Plani do të përfshijë veçanërisht kërkesat e përgjithshme për planet rajonale të

[8] Plani i Biznesit për rajonin dhe çdo bashki duke përfshirë strategjinë për mbulimin e kostos.

përcaktuara nga legjislacioni shqiptar, konceptin organizativ dhe financiar të MMN-së për të gjithë Qarkun e Beratit dhe dhënie përparësi Masave afat-gjata për Investime Rajonale[9] të nevojshme për zbatimin e planit. Gjatë hartimit të planit do të analizohet dhe përcaktohet roli i publikut dhe sektorit privat.

Pas miratimit me sukses të planit rajonal të MMN-së nga të pesë bashkitë, do të ndërmerret një Studim Fizibiliteti, që është edhe objektivi i dytë i komponentit 2. Studimi do të specifikojë dhe shqyrtojë Masat e Investimit Rajonal përcaktuar në Planin Rajonal për MMN-në për sa i përket mundësive teknike, ekonomike, mjedisore dhe sociale. Studimi i Fizibilitetit do të përgatiti këto produkte: (i) një projektim të detajuar teknik të masave të investimit, (ii) analizën e bazuar të kostove dhe modelimit të tarifave, skemës financiare, (iii) vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe social, analizës së riskut, zbatimit dhe planit të monitorimit. (iv) Studimi i Fizibilitetit do të analizojë nevojën dhe shtrirjen e asistencës teknike për një zbatim të qëndrueshëm të masave të investimit. (v) Studimi i Fizibilitetit do të krijojë bazat për projektimin dhe zbatimin e një Projekti të mundshëm II në vazhdimësi ose Projekteve të financuara nga donatorë të tjerë.

Rezultati i komponentit 2: Përmirësimi i kushteve kuadër të shërbimeve të MMN-së: hartimi i politikave për MMN-në, miratohen politikat dhe krijohen kushtet për zbatim. Në Planin MMN përfshihen konsiderata dhe angazhime për integrimin në të ardhmen të sektorit jo-formal, pra Komunitetit Rom dhe grupeve të tjera etnike përfshirë në mbledhjen e mbetjeve, në sistemin e ardhshëm MMN.

3. **Komponenti i tretë: Rritja e ndërgjegjësimit dhe Informimi i Publikut**

Komponenti 3 lidhet me hartimin e strategjisë për rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit të publikut për të rrënjosur një sjellje dhe qëndrim më miqësor ndaj mjedisit mes qytetarëve dhe vendim marrësve në bashki dhe për të përgatitur terrenin për zbatimin me sukses të Planit Rajonal MMN. Mbështetja e popullsisë për zhvillimin e sektorit MMN do të përforcohet përmes fushatave të ndërgjegjësimit të përshtatura për grupet e synuara kyçe. Informimi i vazhdueshëm i publikut për hartimin e Planit Rajonal të MMN, Studimin e Fizibilitetit (komponenti 2) dhe realizimin e Masave Afat Shkurtra (komponenti 4) do të stimulojë më tej popullatën dhe bashkitë të mbështesin proceset e ndryshimit.

Rezultati i Komponentit 3: Rrënjoset sjellja miqësore ndaj ambientit dhe fillimi i ndryshimit të qëndrimit mes qytetarëve dhe vendimmarrësve të rajonit të Beratit.

4. **Komponenti i katërt: Projektimi dhe zbatimi i Masave Afat Shkurta (Masat pa keqardhje):**

Komponenti 4 lidhet me Masat Afat Shkurtra, identifikuar në fazën fillestare, dhe që do të hartohen dhe zbatohen në çdo bashki. Këto masa përqendrohen në prekshmëri të lartë dhe mbështesin ndërgjegjësimin e vendim marrësve dhe qytetarëve. Ato mund të përfshijnë blerjen e pajisjeve të vogla për menaxhimin e mbetjeve si kazanë për ndarjen e mbetjeve, kontejnerë, pajisje riciklimi ose uniforma për nëpunësit civilë apo masa specifike për përmirësimin e mjedisit. Për shembull , rehabilitimi i pikave ekzistuese të depozitimit për mbrojtjen e mjedisit pranë lumenjve dhe paraqitjen e praktikave të

[9] Të tilla si stacione transferimi, mjete transporti, impiante trajtimi dhe landfille higjienike.

kontrolluara të largimit. Zbatimi me sukses i Masave Afat Shkurtra do të evidentojë angazhimin dhe kapacitetin e bashkive për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve për menaxhimin e mbetjeve (realizuar në një Projekt të dytë të mundshëm, përqendruar në zbatimin Masave për Investim Rajonal). Shërbimet në kuadrin e komponentit të katërt do të ofrohen nga furnitorë kombëtarë ose ndërkombëtarë, në varësi të natyrës dhe kërkesave të Masave Afat Shkurtra.

Rezultati i komponentit 4: Zbatimi i masave Afat Shkurtra mbështet reduktimin e dëmit mjedisor në Qarkun e Beratit dhe jep kontribut për zbatimin e Planit Rajonal për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta.

Një Konsulent dhe ekipi i tij me ekspertizë të specializuar në MMN dhe zhvillimin e kapaciteteve, i përbërë nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë do të ofrojë shërbimet për të gjithë komponentët e Projektit.

Shtojca 2: **Kuadri Logjik**

(Kuadri Logjik është në fazë hartimi dhe do të përfundohet gjatë fazës fillestare. Versioni përfundimtar dhe çdo përditësim i Kuadrit Logjik janë subjekt miratimi nga Komiteti Drejtues)

Projekti i Manaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Qarku Berat	**Shqipëri**	**COO.2101.104.4.1280642**

(Me shkrim të errët: Treguesit standard të SECO-s)

Strategjia e Ndërhyrjes	Treguesit Kyç të Performancës	Mjetet e Verifikimit	Faktorët e Jashtëm (Supozime/S / Risqe /R)
Ndikimi	**Treguesit e ndikimit**		
- 231,163 qytetarë të Qarkut të Beratit jetojnë në qytete dhe fshatra të pastra me kushte të përmirësuara higjienike, shijojnë përmirësimin e cilësisë së jetesës, shëndetit dhe veprimtarive të biznesit.	- Perceptimi i qytetarëve për cilësinë e jetesës - Treguesit e shëndetit (për t'u përcaktuar) - Cilësia e ujërave të lumenjve Osum dhe Devoll - Investimet bashkiake për infrastrukturën publike	- Kënaqësia Konsumatore/marrje informacioni mbi perceptimin - Monitorimi i parametrave ujore të lumenjve - Mbështetja buxhetore bashkiake për menaxhimin e mbetjeve e ngurta	- S: zhvillimi i përgjithshëm i qëndrueshëm ekonomik, bazuar në parashikimin e FMN për rritjen e PPB në 4.5% deri në 2020, do të lejojë përmirësimin e mbulimit të kostos për investimet mjedisore nga popullësia - S: Vullnet politik dhe konsesus ndër partiak për miratimin e legjislacionit të ri dhe reformës institucionale
Rezultati	**Treguesit e rezultatit**		
Komponenti 1: Mbështetje për Zhvillimin Institucional dhe të Kapaciteteve Sektorët bashkiakë dhe stafi i MMN-së janë në gjendje të planifikojnë dhe ofrojnë shërbime të përmirësuara dhe të qëndrueshme në zonat aktuale dhe të mundshme rurale.	- Aftësitë e nevojshme të stafit për të zbatuar Planin Rajonal të MMN - Përdorimi i instrumenteve aktuale dhe të reja për MMN - Miratimi i Plan Biznesit (Strategjia e mbulimit të shpenzimeve) - **Mundësisht: numri i personave që do të kenë akses në shërbimet e përmirësuara të mbetjeve të ngurta** - **Mundësisht: Fusha e shërbimeve të Menaxhimit të mbetjeve të Ngurta**	- Vlerësimi i nevojave për kapacitete - Strategji për Zhvillimin e Kapaciteteve - Pjesëmarrja e stafit në tryeza pune/trajnime - Të dhënat e mbledhura nga bashkitë - Raporte monitorimi - Statistika Bashkiake - Të dhëna gjeografike mbi mbledhjen e mbetjeve të ngurta	- S: Mbështetje bashkive për zbatimin e riorganizimit dhe përmirësimit të shërbimeve - S: Konfirmimi i disponueshmërisë për bashkë-financimin nga 5 bashkitë të Qarkut të Beratit

Strategjia e Ndërhyrjes	Treguesit Kyç të Performancës	Mjetet e Verifikimit	Faktorët e Jashtëm (Supozime/S / Risqe /R)
Komponenti 2: Hartimi i Planit për Menaxhimin e Mbetjeve të ngurta dhe Studimit të Fizibilitetit Përmirësimi i kushteve kuadër për shërbimet e MMN; hartimi dhe miratimi i politikave për shërbimin e MMN dhe përcaktimi i kushteve për zbatimin. Përfshirja në Planin MMN të konsideratave dhe angazhimeve për përfshirjen e sektorit jo-formal, pra Komunitetit Rom dhe grupeve të tjera etnike, të angazhuara në mbledhjen e mbetjeve. Studimi i fizibilitetit hedh bazat për financimin e Masave Rajonale të Investimit.	- Angazhimi i pesë bashkive në funksion të zbatimit të Planit Rajonal të MMN - **Numri i masave, përmirësimeve, reformat organizative në funksion të zbatimit të Planit Rajonal** - Shkalla e përfshirjes dhe kontributit të sektorit jo-formal në hartimin e Planit Rajonal të MMN - Shkalla e angazhimit të autoriteteve dhe grupeve të tjera të interesit për të integruar sektorin jo-formal në procesin e MMN-së në të ardhmen. - Krijimi i bazave konkrete për integrimin e sektorit jo-formal në MMN, të tilla si koncepte dhe burime për ngritjen e kapaciteteve, formimi i shoqatave dhe punësimit - Vlerësohen mundësitë e financimit për Masat e Investimeve Rajonale Përcaktohet struktura e mundshme e financimit	- Kontributi i bashkive për hartimin e Planit - Kontributi i bashkive për hartimin e Studimit të Fizibilitetit - Pjesëmarrja dhe kontributi i sektorit jo-formal në tryezat përkatëse të punës - Studimi i Fizibilitetit	- R: Rezistencë e sektorit jo-formal për të marrë pjesë në procesin e hartimit të Planit Rajonal për MMN
Komponenti 3: Rritja e ndërgjegjësimit dhe Informimi i Publikut Nis të rrënjoset sjellja miqësore ndaj mjedisit dhe fillimi i ndryshimit të qëndrimit mes qytetarëve dhe vendim marrësve të Qarkut të Beratit	- Ndërgjegjësimi i qytetarëve në lidhje me sjelljen në përgjithësi për MMN dhe në veçanti praktikave të reja (ndarja e mbetjeve, riciklimi) - Ndikimi i fushatave të ndërgjegjësimit	- Kërkime më lidhje me qëndrimin dhe sjelljen ndaj shërbimeve MMN dhe mbrojtjes së mjedisit - Kërkime mbi efektin fushatave të ndërgjegjësimit dhe informimit të publikut (krijimi i shprehive, mirëkuptimi i çështjeve të mjedisit)	- S: Berati, si qytet me numër të madh të popullsisë me moshë të re, ofron një mundësi të madhe për zbatimin e një fushate novatore ndërgjegjësimi dhe edukimi, ashtu si dhe veprimtari vullnetare për pastrimin, ndarjen dhe mbledhjen e mbetjeve.
Komponenti 4: Projektimi dhe Zbatimi i Masave Afat-shkurtra (Masave pa keqardhje) Zbatimi i Masave Afat Shkurtra mbështet reduktimin e dëmit në mjedis në Qarkun e Beratit dhe jep kontribut në Zbatimin e Planit Rajonal të MMN.	- Reduktimi i numrit të "pikave/vendeve të hedhjes kritike" - Pranimi nga popullata i Masave Afat Shkurtra	- Kërkime për perceptimin e shërbimeve të MMN - Kërkime mbi Masat Afat Shkurtra	- S: Autoritetet bashkiake të Beratit tregojnë pronësi të fortë të kontributit vendor prej 20% në komponentin 4 të projektit në fjalë
Përfundimi	**Treguesit e Përfundimit**		
Komponenti 1: Mbështetje për Zhvillimin	- Analiza e grupeve të interesit	- Disponueshmëria e analizës së	

Strategjia e Ndërhyrjes	Treguesit Kyç të Performancës	Mjetet e Verifikimit	Faktorët e Jashtëm (Supozime/S / Risqe /R)
Institucional dhe të Kapaciteteve Identifikimi i nevojave për Zhvillim Kapacitetesh; Përcaktimi dhe zbatimi i Masave për Zhvillimin e Kapaciteteve. Analiza e kontekstit vendor të sektorit të MMN-së ofron të gjithë elementët e nevojshëm për hartimin e Planit Rajonal të MMN, për Studimin e Fizibilitetit dhe për përcaktimin e masave për zhvillimin organizativ.	- Strategjia e Zhvillimit të Kapaciteteve - Instrumentet përkatëse të monitorimit - Vlerat bazë dhe të synuara për treguesit kyç	grupeve të interesit, Vlerësimit të Nevojës për Kapacitete, Strategjisë së Zhvillimit të Kapaciteteve dhe Planit të Zbatimit - Instrumentet e monitorimit dhe trajnimi përkatës - Pjesëmarrja e stafit në trajnime - Kuadri i rezultateve	
Komponenti 2: Hartimi i Planit për Menaxhimin e Mbetjeve të ngurta dhe Studimit të Fizibilitetit Plani Rajonal për Menaxhimin e Mbetjeve hartohet dhe miratohet së bashku me grupet e interesit. Studimi i Fizibilitetit hartohet dhe miratohet së bashku me grupet e interesit	- Plani Rajonal MMN - Studimi i Fizibilitetit	- Dekretet e miratimit	- R: Mungesa e konsensusit mes bashkive në lidhje me Masat për Investimet Rajonale
Komponenti 3: Ritija e ndërgjegjësimit dhe Informimit të Publikut Hartimi dhe zbatimi i Strategjisë për Rritjen e Ndërgjegjësimit dhe Informimit të Publikut Realizimi efikas dhe i frytshëm i masave për rritjen e Ndërgjegjësimit dhe Informimin e Publikut	- Miratimi i strategjisë për rritjen e Ndërgjegjësimit dhe Informimin e Publikut - Masat për rritjen e Ndërgjegjësimit dhe Informimin e Publikut	- Kërkime mbi efektin e fushatave të Ndërgjegjësimit dhe Informimit të Publikut (krijimi i shprehive dhe të kuptuarit e çështjeve të mjedisit)	
Komponenti 4: Projektimi dhe Zbatimi i Masave Afat-shkurtra (Masave pa kequrdhje) Identifikimi dhe zbatimi i Masave Afat Shkurtra.	- Plani i Masave Afat Shkurtra	- Masat Afat Shkurtra - Shqyrtimi i zbatimit të Masave Afat-shkurtra	

Shtojca3: Plan Projekti

(Ky është një Plan Projekt i përkohshëm. Plani varet nga Fillimi i Projektit dhe gjetjet gjatë fazës fillestare)



Shtojca 4: Projekt Buxheti

Buxhet i përkohshëm. Përllogaritja e shpenzimeve përfshin edhe 20% e bashkëfinancimit nga burime shqiptare për Masat Afat Shkurtra (komponenti 4).

Komponenti	Shpenzimet e përllogaritura (CHF)	
Komponenti 1: Mbështetje Institucionale dhe Zhvillimi i Kapaciteteve		330'000
Shërbimet e Konsultimit kombëtar dhe ndërkombëtar (Komponenti. 1)	250'000	
Aktivitete, tryeza pune (logjistikë)	80'000	
Komponenti 2: Hartimi i Planit për Menaxhimin e Mbetjeve të ngurta dhe Studimit të Fizibilitetit		350'000
Shërbimet e Konsultimit kombëtar dhe ndërkombëtar (Komponenti. 2)	350.000	
Komponenti 3: Rritja e Ndërgjegjësimit dhe Informimit të Publikut		350'000
Masat për rritjen e Ndërgjegjësimit dhe të Informimit të Publikut	300'000	
Shërbimet e Konsultimit kombëtar dhe ndërkombëtar (Komponenti. 3)	50'000	
Komponenti 4: Masat Afat-Shkurtra (përfshihet bashkëfinancimi)		1'000'000
Masat Afat-shkurtra (për shembull: Rehabilitimi i Vend-Hedhjeve, Përmirësimi i grumbullimit të mbetjeve, Projekte pilot për ndarjen e mbetjeve dhe mbetjet e riciklueshme)	900'000[2]	
Shërbimet e Konsultimit kombëtar dhe ndërkombëtar (Komponenti. 4)	100'000	
Shpenzimet për Konsulentin(ët) kombëtar(ë) dhe ndërkombëtar(ë) (udhëtimi, zyra)		100'000
Fondi për rastet e paparashikuara		200'000
Vlerësimi i Projektit		50'000
Auditi Financiar		20'000
Shuma		**2'400'000**

Buxheti është subjekt i gjetjeve në fazën fillestar. Mund të ketë një lëvizje të lehtë të fondeve midis komponentëve.

[2] Kontributi i SECO: 700'000 CHF, kontributi i Bashkive Berat, Kuçovë, Ura Vajgurore, Poliçan dhe Çorovodë: 200'000 CHF.

VENDIM
Nr. 461, datë 10.6.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 661, DATË 7.8.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJAVE 110 kV DHE 220 kV, QË LIDHIN KASKADËN E DEVOLLIT ME SISTEMIN E TRANSMETIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 661, datë 7.8.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 3, shifra "3 610 343.8 (tre milionë e gjashtëqind e dhjetë mijë e treqind e dyzet e tre pikë tetë) lekë" ndryshon dhe bëhet "3 908 239.5 (tre milionë e nëntëqind e tetë mijë e dyqind e tridhjetë e nëntë pikë pesë) lekë".

b) Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

"4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 3 908 239.5 (tre milionë e nëntëqind e tetë mijë e dyqind e tridhjetë e nëntë pikë pesë) lekësh, të përballohet nga shoqëria "Devoll Hydropower", sh.a.".

c) Tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohet tabela bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, zyra vendore Gramsh dhe shoqëria "Devoll Hydropower", sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Qarku/ Elbasan/ Fshati	Nr. Rendor	Nr. i shtyllave	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sasia e sip. së pronës m²	Sipërfaqe shpronësimi definitiv m²	Çmimi i tokës lekë /m²	Vlera e kompensimit
Fshati Malasej	1	30	Qani	Hasan	Kabashi	arë	2559	121/4	3000	74.0	222	16428.0
	2	31	Shpetim	Mehdi	Hoxha	arë	2559	113/22	1400	6.0	222	1332.0
	3	32	B/P Hoxha			Arë	2559	arë	2800	4.0	222	888.0
	4	33	Bashkim	Sali	Kamami	arë	2559	24/7	5750	8.0	222	1776.0
Fshati Shtërmen	1	23	Robert	Venemin	Xhania	arë	3422	224/75	2000	13.0	222	2886.0
	2	25	Agron	Jorgji	Mema	arë	3422	237/24	3600	7.0	222	1554.0
	3	22	Todi	Pali	Doka	arë	3422	291/4	2750	72.0	222	15984.0
Fshati Cërrik 2	1	42	Xhevahire	Qemal	Rusi	arë	2281	263/3	3750	37.0	263	9731.0
	2	41	Asije	Shane	Isaj	arë	2281	285/8	3750	28.4	263	7469.2
	3	40	Besnike	Sali	Carciu	arë	2281	288/7	4500	25.0	263	6575.0
	4	36	Naxhije	Hysen	Cekrezi	arë	2281	295/6	1500	10.0	263	2630.0
	5	36	Koze	Ymer	Cekrezi	arë	2281	295/7	3000	19.0	263	4997.0
	6	35	Shaban	Ramazan	Nasufi	arë	2281	296/6	6000	29.0	263	7627.0
	7	34	Altin Rozeta	Riza Bajram	Rabushja Rabushja	arë	2281	297/24	2500	44.5	263	11703.5
	8	37	Suzana	Demir	Mustafaj	arë	2281	301/22	2250	25.0	263	6575.0
LISTA E PRONARËVE PËR SHPRONËSIM PËR EFEKT TË NDËRTIMIT							**LINJËS 220 kV**					
Gramsh-Fshat	1	50	Avni	Zylal	Mema	arë	1844	5/5	3,000	140.00	174.00	24360.0
Fshati Kryezjarth	1	104	Gazmend Merkur Kuri	Kuri Spiro Spiro	Doka Doka Doka	arë	2296	34/8	1,350	51.00	222.00	11322.0
	2	104	Merkur	Simon	Drizari	arë	2297	33/3	10,140	107.00	222.00	23754.0
Fshati Mjekes	1	107	Nevruz	Sadik	Xhika	arë	2703	151/1	1400	148	222.00	32856.0
LISTA E PRONARËVE PËR SHPRONËSIM PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË NËNSTACIONIT ELBASAN												0.0
Bashkia Elbasan	1		Shefik Zyliha Astrit	Tafil Haxhi Feri	Demoreti Demoreti Keco	Are	8526	430/14	2000	484	222.00	107448.0
Shuma totale												**297895.7**

VENDIM
Nr. 462, datë 10.6.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 599, DATË 31.8.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I RRUGËS 'DHIMITËR KONOMI', NË ZONËN E UJIT TË FTOHTË, VLORË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 599, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 3, shifra "27 776 834 (njëzet e shtatë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e katër) lekë" ndryshon dhe bëhet "28 267 469 (njëzet e tetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë".

b) Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

"4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 28 267 469 (njëzet e tetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekësh, të përballohet, si më poshtë vijon:

- 27 776 834 (njëzet e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e katër) lekë, nga llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë;
- 490 635 (katërqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë) lekë, nga buxheti i miratuar për Bashkinë Vlorë.".

c) Pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon:

"5. Shpenzimet procedurale të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.".

ç) Tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohet tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Vlorë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Nr.	Emër, mbiemër	Adresa	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. totale truall (m^2)	Sip. truall prekur	Çmimi truall (lekë/m^2)	Vlera e përgjithshme (lekë)	Gjendja juridike e pasurisë
46	Fotaq Konomi, Nikollaq Konomi	Vlorë	truall	8602	43/4/1	500	45	10,903	490,635	Konfirmuar nga ZVRPP-ja më datë 26.10.2018
Vlera e shpronësimit							**45**	**10.903**	**490,635**	

VENDIM
Nr. 463, datë 10.6.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 231, DATË 17.4.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I SEGMENTIT RRUGOR "PALLATI ME SHIGJETA – RRETHRROTULLIMI 'SHQIPONJA'", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 231, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pikat 3 dhe 4 ndryshohen si më poshtë vijon:

"3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit "truall", "tokë arë" dhe "ndërtesë", me një vlerë të përgjithshme prej 1 637 923 893.36 (një miliard e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë milionë e nëntëqind e njëzet e tre mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre pikë tridhjetë e gjashtë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 637 923 893.36 (një miliard e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë milionë e nëntëqind e njëzet e tre mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre pikë tridhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet, si më poshtë vijon:

- 1 224 874 430.42 (një miliard e dyqind e njëzet e katër milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e katërqind e tridhjetë pikë dyzet e dy) lekë, nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;

- 158 067 603.10 (njëqind e pesëdhjetë e tetë milionë e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tre pikë dhjetë) lekë, nga buxheti i miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar;

- 200 000 000 (dyqind milionë) lekë, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2020;

- 54 981 859.84 (pesëdhjetë e katër milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë tetëdhjetë e katër) lekë, nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vitin 2021.".

b) Vlera e shpenzimeve procedurale, prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh, përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

c) Tabelës bashkëlidhur vendimit nr. 231, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, i shtohet tabela bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria Vendore Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, PASURITË E PALUAJTSHME TË TË CILËVE, PREKEN NGA DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 231, DATË 17.04.2019 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I SEGMENTIT RRUGOR ' PALLATI ME SHIGJETA – RRETHRROTULLIMI 'SHQIPONJA"", I NDRYSHUAR

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Sip. totale m²	Lloji i pasurisë	TOKË TRUALL			TOKË ARË			NDËRTESË SOC. EK		OBJEKT BANIMI			VLERA totale (LEKË)	SHËNIME
								Sipërfaqja e shpr. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera lekë	Sipërfaqja e shpr. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera lekë	Sipërfaqja e shpr.(m²)	Vlera sipas preventivit lekë	Sipërfaqja e shpr.(m²)	Çmimi m²	Vlera lekë		
1	Bp Llagami,Saraçi			8210	7/272	680	truall	680	38,614.00	26,257,520.00									26,257,520.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Bp Peto, Rebeshi			8210	7/533	1937	truall	310.6	38,614.00	11,993,508.40									11,993,508.40	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	Erjon	Dashi	Satko	8210	7/475	1422	truall	28.8	38,614.00	1,112,083.20									1,112,083.20	Konfirmuar nga ASHK-ja
4	Bp Llagami,Saraçi			8210	7/503	805.6	truall	30	38,614.00	1,158,420.00									1,158,420.00	Konfirmuar nga ASHK-ja (në seksionin D dhe E ka shënimin që mbi këtë pas ka ndërtime informale dhe formale)
5	Bp Llagami,Saraçi			8210	7/413	400	truall	57	38,614.00	2,200,998.00									2,200,998.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
6	Bp Llagami,Saraçi			8210	7/530	255.5	truall	186.3	38,614.00	7,193,788.20									7,193,788.20	Konfirmuar nga ASHK-ja
7	Dashi	Alo	Satko	8210	7/476	378	truall	77.9	38,614.00	3,008,030.60									3,008,030.60	Konfirmuar nga ASHK-ja
8	Bp Llagami,Saraçi			2679	440/434	1050	truall	1050	4,242.00	4,454,100.00									4,454,100.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
9	Bp Merna, Hyseni, Dorezi, Daiu, Sumbulla			2679	440/71	300	arë				206.6	448	92,556.80						92,556.80	Konfirmuar nga ASHK-ja
10	Bp Dervishi, Boçi			2679	440/69	385	arë				191	448	85,568.00						85,568.00	Sek. konsv. nr. 87 prot. datë 18.1.2013
11	Bp Dervishi, Boçi			2679	440/68	2000	arë				220.8	448	98,918.40						98,918.40	Sek. konsv. nr. 87 prot. datë 18.1.2014
12	Euro-alba-ea shpk			8310	12/127	217	truall	21.8	31,219.00	680,574.20			0.00						680,574.20	Barrë hipotekore nga Drejtoria e Tatimeve
13	Euro-alba-ea shpk			8310	12/51	5443.7	truall	199	31,219.00	6,212,581.00			0.00					0	6,212,581.00	Konfirmuar nga ASHK-ja (në seksionin D ka shënimin që mbi këtë truall ndodhet pas me nr. 12/2ND dhe seksionin E ka shënimin ka ndërtim informal)
14	Bolv-oil sha			8310	12/301	15432.5	truall	141	31,219.00	4,401,879.00			0.00					0	4,401,879.00	Në favor të "Raiffeizen Bank" sh.a. për shumen 5.5 milion euro
15	Bp, Spiro , bejleri, Berami, Shijaku			8310	12/304	1251	truall	212.7	31,219.00	6,640,281.30			0.00					0	6,640,281.30	Në dispozicion të palës sipërmarrëse shoqëria "Rinia 04" sh.p.k.
16	Besnik		Myrtaj	8310	12/24	300	truall + ndërtesë	300	31,219.00	9,365,700.00			0.00	112	1,454,546.48			0	10,820,246.48	Në dispozicion të palës sipërmarrëse shoqëria "Rinia 04" sh.p.k.
17	Gentian	Bashkim	Leskaj	8310	12/23	678	truall	57.7	31,219.00	1,801,336.30			0.00					0	1,801,336.30	Në dispozicion të palës sipërmarrëse shoqëria "Rinia 04" sh.p.k.
18	Bp Lika,Velo,Sulstarova etj.			8310	12/139	882	truall	862.6	31,219.00	26,929,509.40			0.00					0	26,929,509.40	Konfirmuar nga ASHK-ja (në seksionin E ka shënimin mbi këtë pas ka tri ndërtime të paligjshme)
19	Anton		Gjinaj	8310	12/115	1337	truall	48.1	31,219.00	1,501,633.90			0.00					0	1,501,633.90	Hipotekohet në favor të "Procredit Bank" për shumën 2 milionë euro
20	Sefedin		Bitri	8310	12/116	850	truall	104	31,219.00	3,246,776.00			0.00					0	3,246,776.00	Konfirmuar nga ASHK-ja (në seksionin E ka shënimin mbi këtë pas ka dy ndërtimetë paligjshme)
21	Bp. Canameri , Çelmeta, Agolli			8310	12/21	922	truall	141.4	31,219.00	4,414,366.60			0.00					0	4,414,366.60	Në favor te shoqëria "M.C inerte" sh.p.k.

22	Bp Sinani, Veshi,Dado, Çarçani,Gulo,Kondakçiu,Durrsi, Shahu,Zoto			8310	12/19	3934.66	truall	23.8	31,219.00	743,012.20			0.00					0	743,012.20	Konfirmuar nga ASHK-ja
23	Colombo II Sh.p.k. Veko Sh.p.k.			8310	12/298	6000	truall	562.5	31,219.00	17,560,687.50			0.00					0	17,560,687.50	Konfirmuar nga ASHK-ja (në seksionin E ka shënimin mbi këtë pas ka ndërtime të paligjshme)
24	Bp Doçi, ALB STAR, Gjinaj, Resuli, Elshani, Euro shpk Alba EA, Bitri, Manushi, Istrefi			8310	12/117	5488	truall	94.3	31,219.00	2,943,951.70			0.00					0	2,943,951.70	Sek. konserv. mbi pjesën prej 3.5 % të A. Gjinaj me nr. 150/1 prot. datë 20.2.2012
25	Arben	Lush	Qokaj	2679	440/338	190.1	truall	87.5	4,242.00	371,175.00			0.00					0	371,175.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
26	Banka	Amerikane	Investimeve	2679	440/53	1730	truall	186	4,242.00	789,012.00			0.00					0	789,012.00	Masë sekuestro nr. 10294 datë 29.8.2016
27	Skender		Doda	2679	440/298	500	truall	8.4	4,242.00	35,632.80			0.00					0	35,632.80	konfirmuar nga ASHK
28	Ismail	Xhetan	Nesimi	2679	440/337	326.2	truall	39	4,242.00	165,438.00			0.00					0	165,438.00	Në favor të "Banka Societe Generale Albania" sha.a
29	Bashkim		Kraja	2679	440/430	96	truall	12.2	4,242.00	51,752.40			0.00					0	51,752.40	Konfirmuar nga ASHK-ja
30	Fiqirete	Muharem	Shima	2679	440/278	205	truall	14.7	4,242.00	62,357.40			0.00					0	62,357.40	Konfirmuar nga ASHK-ja
31	Flamur	Matosh	DajÇi	2679	440/327	714.8	truall	32.2	4,242.00	136,592.40			0.00					0	136,592.40	Konfirmuar nga ASHK-ja
32	Rasim	Tahir	Kraja	2679	440/432	217.7	truall	27.5	4,242.00	116,655.00			0.00					0	116,655.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
33	Ramiz	Skender	UruÇi	2679	440/365	293	truall + ndërtesë	34.2	4,242.00	145,076.40			0.00			428.1	53500	22903350	23,048,426.40	Konfirmuar nga ASHK-ja
34	Latif	Ramiz	Perkola	2679	440/416	481	truall	40.5	4,242.00	171,801.00			0.00					0	171,801.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
35	Mustafa	Novruz	TaÇi	3866	306/352	270	ndërtesë			0.00			0.00	**189.30**	5,141,297.82			0	5,141,297.82	Në favor të "BKT"
36	Lefterie		Gjoka	8310	10/243	1190	truall	80.6	31,219.00	2,516,251.40			0.00					0	2,516,251.40	Konfirmuar nga ASHK-ja
37	V8F208 - V8F219			8310	12/17	580	truall	134.16	31,219.00	4,188,341.04									4,188,341.04	Konfirmuar nga ASHK me shkresën nr.12617/1 prot., datë 10.01.2020. Në pritje të saktësimit te bashkëpronarëve nga ASHK, Drejtoria Vendore Tirana Veri.
38	Ilir	Enver	Hoxha	8310	12/17+1-12	89.85	apartament									89.85	70000	6289500	6,289,500.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
39	Ilir Enver Hoxha Teuta Reshat Hoxha			8310	12/17+1-8	97.1	apartament									97.1	70000	6797000	6,797,000.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
40	Rustem	Shefqet	Peçi	8310	12/17+1-5	61.7	apartament									61.7	70000	4319000	4,319,000.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
41	Spartak	Haki	Toska	8310	12/17+1-7	90.5	apartament									90.5	70000	6335000	6,335,000.00	Konfirmuar nga ASHK-ja (seksioni E vendoset masë e sekuestros konservative)
42	Ekaterina Mihal Toska Hektor Haki Toska			8310	12/17+1-6	81.9	apartament									81.9	70000	5733000	5,733,000.00	Konfirmuar nga ASHK-ja (seksioni E vendoset masë e sekuestros konservative)
43	Hasan	Pasho	Paja	8310	12/17+1-3	97.1	apartament									97.1	70000	6797000	6,797,000.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
44	Mimoza	Polikron	Lace	8310	12/17+1-11	23.6	apartament									23.6	70000	1652000	1,652,000.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
45	Blerina	Klement	Kolaneci	8310	12/17+1-9	83.9	apartament									83.9	70000	5873000	5,873,000.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
46	Blerina	Klement	Kolaneci	8310	12/17+1-10	47	apartament									47	70000	3290000	3,290,000.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
47	Arif	Ibrahim	Murati	8310	12/17+1-2	90.5	apartament									90.5	70000	6335000	6,335,000.00	konfirmuar nga ASHK-ja (urdhër kufizimi seksioni E në favor të "Union Bank")
48	Shefqet Isa Peci Xhano Muharrem Peci			8310	12/17+1-5/1	61.7	apartament									61.7	70000	4319000	4,319,000.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
49	Gerantina Felek Peçi Rustem Shefqet Peçi			8310	12/17+1-4/1	64.5	apartament									64.5	70000	4515000	4,515,000.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
50	Gerantina Felek Peçi Rustem Shefqet Peçi			8310	12/17+1-4	64.5	apartament									64.5	70000	4515000	4,515,000.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
51	Bp(Bumçi,Koleka)			8310	12/17+1-1	83.79	apartament									83.79	70000	5865300	5,865,300.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
SHUMA TOTALE								**5,886.46**		**152,570,822.34**	**618.40**		**277,043.20**	**301.30**	**6,595,844.30**	**1,465.74**		**95,538,150.00**	**254,981,859.84**	

VENDIM
Nr. 464, datë 10.6.2020

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2020, MIRATUAR PËR MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në programin buxhetor "Transporti rrugor" 04520, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm" i shtohet fondi prej 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekësh, për projektin "Rishikimi i studimit të fizibilitetit dhe hartimi i projektit të detajuar inxhinierik 'Ndërtimi i tunelit të Llogorasë'", me vlerë të plotë të parashikuar 750 000 000 (shtatëqind e pesëdhjetë milionë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2020.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 465, datë 10.6.2020

PËR DHËNIEN E BURSAVE PËR NXËNËSIT E SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE "PETER MAHRINGER", SHKODËR, PËR VITIN SHKOLLOR 2020–2021

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 39, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 9522, datë 25.4.2006, "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Austrisë, për bashkëpunimin në fushat e kulturës, të arsimit dhe shkencës", të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të 84 (tetëdhjetë e katër) bursave të studimit për nxënësit e shkollës së mesme profesionale "Peter Mahringer", Shkodër, nga të cilat 24 (njëzet e katër) bursa studimi për nxënësit e viteve përgatitore dhe 60 (gjashtëdhjetë) bursa studimi për nxënësit nga viti i parë, deri në vitin e katërt të shkollës së mesme profesionale "Peter Mahringer", për vitin shkollor 2020–2021.

2. Vlera vjetore e bursës do të jetë 95 600 (nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind) lekë, me qëllim shlyerjen e tarifës mujore të shkollimit dhe për mbulimin e kostos së teksteve mësimore. Vlera e masës së bursës do të paguhet pranë bankave të nivelit të dytë për çdo nxënës/ prind/ përfaqësues ligjor të nxënësve përfitues.

3. Fondi për mbulimin e këtyre bursave kalon nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar në Shkodër.

4. Miratimi i këtyre bursave bëhet nga bordi i Fondacionit Shkollor Austriak, pas përzgjedhjes mbi bazën e kritereve ekonomike, si dhe rezultateve të arritura nga secili nxënës/aplikant.

5. Bordi i Fondacionit Shkollor Austriak, pas miratimit të bursave, dërgon dokumentacionin përkatës në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar në Shkodër, i cili, pas konfirmimit të nxënësve që përfitojnë bursë, kalon masën e bursës në llogarinë personale të secilit nxënës.

6. Efektet financiare të mbulohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pa efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 466, datë 10.6.2020

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE PËR HAPJEN DHE MBYLLJEN E INSTITUCIONEVE PRIVATE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, NË TË CILAT ZHVILLOHEN EDHE LËNDË FETARE APO KU MËSIMI ZHVILLOHET EDHE NË GJUHË TË HUAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 4 e 5, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për hapjen dhe mbylljen e institucioneve arsimore private të arsimit parauniversitar, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj.

2. Institucione të arsimit parauniversitar privat, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, janë institucionet për nivelet, si më poshtë vijon:

a) kopsht (arsimi parashkollor);

b) shkollë e arsimit fillor;

c) shkollë e arsimit të mesëm të ulët;

ç) shkollë e arsimit bazë;

d) shkollë e arsimit të mesëm të lartë, që është në fushën e përgjegjësisë shtetërore së ministrisë përgjegjëse për arsimin.

3. Aplikimet për hapjen dhe mbylljen e institucioneve private të arsimit parauniversitar, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj kryhen në portalin qeveritar *e-Albania*, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

4. Për çdo institucion arsimor, të përcaktuar në pikën 2 të këtij kreu, paraqitet aplikimi dhe dokumentacion më vete, për çdo nivel arsimor.

KREU II
KRITERET DHE DOKUMENTACIONI PËR HAPJEN E KËTYRE INSTITUCIONEVE ARSIMORE PRIVATE

1. Institucionet private të arsimit parauniversitar, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, hapen kur subjekti kërkues plotëson kriteret e parashikuara në këtë vendim. Në fazën e parë subjekti aplikon në portalin qeveritar *e-Albania*, duke plotësuar të gjitha të dhënat, sipas rubrikave të shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Në rast vlerësimi pozitiv të aplikimit të fazës së parë, nga ministria përgjegjëse për arsimin, subjekti ngarkon elektronikisht dokumentacionin sipas rubrikave të shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Dokumentacioni në gjuhë të huaj ngarkohet i përkthyer në gjuhën shqipe. Kur ky dokumentacion lëshohet në gjuhë të huaj, nga një institucion i huaj, ai duhet të legalizohet, në bazë të legjislacionit në fuqi.

KREU III
PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË SHQYRTIMIT TË DOKUMENTACIONIT

1. Subjekti aplikon në portalin qeveritar *e-Albania* deri në datën 15 mars, për vitin shkollor

pasardhës, duke plotësuar të dhënat për hapjen e institucionit arsimor privat, sipas rubrikave të parashikuara në shtojcën nr. 1, për fazën e parë të aplikimit.

2. Ministria përgjegjëse për arsimin shqyrton aplikimin brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e aplikimit dhe njofton subjektin në formë elektronike për vlerësimin e aplikimit.

3. Në rast vlerësimi pozitiv nga ministria përgjegjëse për arsimin, subjekti ngarkon elektronikisht, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, dokumentacionin e parashikuar në shtojcën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për fazën e dytë të aplikimit.

4. Ministria përgjegjëse për arsimin shqyrton, brenda 30 (tridhjetë) ditëve dokumentacionin, duke kërkuar raport ekspertimi nga institucionet e varësisë të specializuara për vlerësimin e kurrikulave dhe nga Komiteti Shtetëror për Kultet, kur institucioni arsimor privat do të zhvillojë edhe lëndë fetare.

5. Verifikimi i përmbushjes së standardeve të infrastrukturës së institucionit arsimor privat, parashikuar në shtojcën nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, kryhet me kërkesë të ministrisë përgjegjëse për arsimin, nga një grup pune (një prej të cilëve specialist inxhinier) të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit ndodhet vendndodhja e objektit. Grupi i punës përgatit një raport të detajuar vlerësimi, shoqëruar me rekomandimin përkatës për miratimin ose refuzimin e aplikimit.

6. Në përfundim të shqyrtimit, ministria përgjegjëse për arsimin pranon ose refuzon aplikimin. Nëse kërkesa refuzohet, subjekti nuk mund të aplikojë përsëri për atë vit shkollor, për hapjen e një institucioni arsimor privat të arsimit parauniversitar, në të cilin zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj.

7. Në rast të vlerësimit pozitiv, ministri përgjegjës për arsimin i propozon Këshillit të Ministrave projektvendimin për hapjen e institucionit arsimor privat. Propozimi për hapjen e institucionit arsimor privat të arsimit parauniversitar, në të cilin zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, për miratim nga Këshilli i Ministrave duhet të jetë jo më vonë se 3 (tre) muaj para fillimit të vitit shkollor.

KREU IV
TARIFAT E SHËRBIMIT

1. Tarifat e aplikimit për hapje të institucioneve arsimore parauniversitare private, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, janë sipas shtojcës nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Tarifa paguhet në numrin e llogarisë së ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe është e pakthyeshme. Të ardhurat e realizuara nga tarifa derdhen 100% në buxhetin e shtetit.

KREU V
NDRYSHIMI I TË DHËNAVE TË INSTITUCIONIT

1. Subjekti, pas miratimit të hapjes së institucionit arsimor privat të arsimit parauniversitar, në të cilin zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, jo më vonë se 3 (tre) muaj para fillimit të vitit shkollor, aplikon sipas shtojcës nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Subjekti, plotëson dhe ngarkon dokumentacionin përkatës, sipas rubrikave të shtojcës nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, ministria përgjegjëse për arsimin njofton subjektin, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, për:

a) plotësime ose ndryshime të tjera të mundshme në dokumentacion;

b) miratimin e plotësimeve ose të ndryshimeve të mësipërme;

c) ndjekjen e procedurave të mbylljes, sipas pikës 3, të kreut VI, të këtij vendimi.

KREU VI
MBYLLJA E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PRIVAT

1. Mbyllja e institucionit të arsimit privat, në të cilin zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj bëhet me vendim

të Këshillit të Ministrave, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga data e aplikimit.

2. Vendimi për hapjen e institucionit arsimor privat në të cilin zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj shfuqizohet në rastet kur ky i fundit nuk fillon veprimtarinë në 2 (dy) vitet shkollore pasardhëse.

3. Subjekti, që kërkon mbylljen e institucionit arsimor privat, në të cilin zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, aplikon jo më vonë se 3 (tre) muaj përpara përfundimit të vitit shkollor përkatës, nëpërmjet sistemit elektronik, duke ngarkuar dokumentacionin që përmban të dhënat dhe deklarimet, sipas shtojcës nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Mbyllja e institucionit të arsimit privat bëhet në çdo kohë me nismën e ministrit përgjegjës për arsimin, kur:

a) ministria përgjegjëse për arsimin ose institucionet e saj të varësisë konstatojnë shkelje të kritereve ose të standardeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi;

b) në rast mosplotësimi të dokumentacionit dhe/ose të ndjekjes së procedurës të përcaktuar në kreun V të këtij vendimi.

5. Nuk kanë të drejtë të kërkojnë hapjen e një institucioni arsimor privat, për 5 (pesë) vite shkollore pasuese, subjektet dhe themeluesit e tyre, që kanë mbyllur një institucion arsimor privat, në të cilin zhvillohen lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, me nismën e ministrisë përgjegjëse për arsimin apo kërkesën e tyre.

6. Institucioni arsimor privat që mbyllet dorëzon dokumentacionin arsimor pranë arkivit shtetëror vendor, sipas legjislacionit në fuqi për arkivat. Një kopje e procesverbalit të dorëzimit dhe e dokumentacionit depozitohet në njësinë vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilës ndodhej institucioni i mbyllur. Në rast se subjekti nuk e dorëzon dokumentacionin, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e mbylljes së institucionit arsimor privat, administratori i tij mban përgjegjësi administrative, në bazë të legjislacionit në fuqi dhe dënohet me gjobë.

KREU VII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Aplikimet për hapjen dhe mbylljen e institucioneve private të arsimit parauniversitar, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, do të kryhen në formë shkresore, deri në datën 30 qershor 2020, në përputhje me vendimin nr. 825, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

2. Vendimi nr. 825, datë 7.10.2015, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve e të procedurave për dhënien e lejes për hapjen, mbylljen dhe funksionimin e institucioneve private të arsimit parauniversitar, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj", i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen ministria përgjegjëse për arsimin dhe institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1

FORMULAR APLIKIMI
PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PRIVAT, NË TË CILIN ZHVILLOHEN EDHE LËNDË FETARE APO KU MËSIMI ZHVILLOHET EDHE NË GJUHË TË HUAJ

Subjekti: _____
NIPT: _____
Administratori/përfaqësuesi:_____
NID i administratorit/ përfaqësuesit:_____

Unë i/e nënshkruari/a _____, administrator/përfaqësues i subjektit _____, që aplikon për hapje të institucionit arsimor parauniversitar _____, deklaroj:

- Emërtimi i institucionit arsimor parauniversitar:
_____

- Lloji i institucionit arsimor:
_____

- Vendndodhja e institucionit:
_____

- Adresa e postës elektronike:
_____

- Llojet e programeve arsimore që institucioni do të ofrojë për nxënësit:
_____
_____
_____

- Tarifat dhe modalitetet e pagesave që do të kontraktohen me përfituesit e shërbimit:
_____
_____

- Numri i grupeve/klasave që do të hapen në fillim e në pesë vitet në vazhdim dhe parashikimi i përafërt për numrin e nxënësve për klasë:
_____
_____
_____

Deklaratat që plotësohen nga subjekti
- Deklaratë për llojet e programeve arsimore që institucioni do të ofrojë për nxënësit:
_____
_____
_____

- Deklarata për tarifat dhe modalitetet e pagesave që do të kontraktohen me përfituesit e shërbimit;

_____

_____

_____

- Deklarata për strukturën e vitit shkollor, planin mësimor dhe programet mësimore që do të zhvillojë institucioni arsimor privat. Kur, për një lëndë, programi mësimor është i njëjtë me atë të institucioneve analoge arsimore publike, është e mjaftueshme deklarata që e pohon këtë fakt.

_____

_____

_____

PËRSHKRIMI I PROPOZIMIT PËR HAPJE TË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PRIVAT, NË TË CILAT ZHVILLOHEN EDHE LËNDË FETARE APO KU MËSIMI ZHVILLOHET EDHE NË GJUHË TË HUAJ

a) Të dhëna mbi institucionin:

i. në këtë seksion duhet të përfshihen të dhëna mbi elementet e mëposhtme:

Analizë e situatës prej të cilës buron nevoja që subjekti do të ndërmarrë për hapjen e institucionit arsimor privat;

ii. risia që sjell kjo nismë e re;

iii. përshkrimi i përgjithshëm i misionit, qëllimit dhe objektivave të institucionit arsimor që propozohet të hapet dhe fokus grupi i fëmijëve/nxënësve, që synohet të mësojnë në këtë institucion;

iv. rregullorja e brendshme e institucionit arsimor privat është konform rregullores tip të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin;

v. është marrë miratimi nga bashkësia përkatëse fetare, për hapjen e një institucioni arsimor privat, ku do të zhvillohen edhe lëndë fetare.

b) Drejtuesi didaktik, personeli mësimdhënës dhe administrativ:

Në këtë seksion shtjellohet një përmbledhje e shkurtër mbi drejtorin dhe personelin mësimor, duke përfshirë informacion mbi:

i. numri i personelit;

ii. CV e shkurtuar (bio) e personelit mësimor, që do të angazhohet, të dhëna mbi diplomimin, profili/lënda ku është licencuar. Drejtuesi dhe personeli mësimor plotësojnë kriteret profesionale përkatëse të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

iii. numri i personelit administrativ (specialistë në fushën e mjekësisë, psikologji, punë sociale) dhe punonjës mbështetës (sekretar, sanitar, roje), të dhënat për diplomat/certifikatë;

iv. ngarkesa mësimore të mësuesve është në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

c) Infrastruktura në funksion të institucionit:

Ky seksion përmban informacion të përmbledhur mbi infrastrukturën mësimore në shërbim të institucionit arsimor privat, duke u fokusuar në:

i. ndërtesa dhe mjediset e saj plotësojnë kushtet për sigurinë, të dhëna mbi mjediset e jashtme të institucionit arsimor, si dhe standardet e infrastrukturës, sipas legjislacionit në fuqi;

ii. numri dhe sipërfaqja e klasave, si dhe numri i nxënësve për klasë;

iii. zotërojnë pajisjet dhe mjetet mësimore për funksionimin normal të procesit të mësimdhënies dhe të nxënit. Listën e plotë të pajisjeve, mjeteve mësimore dhe inventarin e mjeteve kryesore të laboratorëve mësimore që do të jenë në funksion të realizimit të programit mësimor.

Unë i nënshkruari (*emër, mbiemër*) deklaroj se të gjitha të dhënat e deklaruara në këtë formular janë të sakta dhe mbaj përgjegjësi të plotë ligjore.

Shënim.

Për çdo nivel arsimor: arsim parashkollor, arsim bazë dhe arsim i mesëm i lartë si dhe për dy rastet e institucioneve arsimore private, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, paraqiten kërkesë dhe dokumentacion i veçantë për çdo aplikim.

SHTOJCA NR. 2
NGARKIMI I DOKUMENTACIONIT

Në rast vlerësimi pozitiv të aplikimit nga ministria përgjegjëse për arsimin, subjekti ngarkon elektronikisht dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Rregulloren e brendshme të institucionit arsimor privat.

b) Strukturën e vitit shkollor, planin mësimor dhe programet mësimore që do të zhvillojë institucioni arsimor privat.

c) Modelin e dokumentit që institucioni arsimor do të lëshojë në përfundim të çdo viti shkollor dhe të nivelit të arsimit. Në rastet e institucioneve që zhvillojnë mësim edhe në gjuhë të huaj, dokumenti ngarkohet në gjuhën në të cilën zhvillohet mësimi dhe në gjuhën shqipe.

ç) Dokumentin miratues nga bashkësia përkatëse fetare, për hapjen e një institucioni arsimor privat, ku do të zhvillohen edhe lëndë fetare.

d) Listën e plotë të personelit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ, numër kontakti dhe adresat tyre elektronike, si dhe dokumentacionin, për:

i. drejtorin e institucionit arsimor, ngarkohen diplomat, licenca për ushtrimin e profesionit sipas kritereve të përcaktuara me ligj, kualifikimi përkatës ku të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar" dhe kontrata e punës;

ii. personelin mësimdhënës ngarkohen diploma/t dhe licenca për ushtrimin e profesionit, sipas kritereve të përcaktuara me ligj. Për shtetasit e huaj, diplomat duhet të jenë të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin;

iii. për punonjësit administrativë, diplomë të arsimit përkatës.

dh) Lejet e qëndrimit dhe lejet e punësimit për shtetasit e huaj që do të punësohen në institucionin arsimor privat.

e) Për mësuesit që do të zhvillojnë në gjuhë të huaj lëndëte profilit të tyre dhe profili nuk është gjuha e huaj, ngarkohet dëshmi për nivelin e gjuhës C1, sipas testeve të njohura ndërkombëtarisht.

ë) Për institucionet arsimore private që do të lëshojnë diplomë të huaj, ngarkohet modeli i diplomës së huaj dhe i përkthyer në shqip, si dhe aktet përkatëse që i japin të drejtën për lëshimin e tyre, sipas legjislacionit në fuqi.

f) Relacionin me planimetrinë për mjediset e godinës ku do të zhvillohet veprimtaria mësimore, nga ekspert i licencuar.

g) Kopje të njësuar të certifikatës së pronësisë së godinës ose kontrata e qirasë/huapërdorjes me afat jo më pak se 3 vjet, shoqëruar me kopje të njësuar me origjinalin të certifikatës së pronësisë së qiradhënësit.

gj) Kopje të lejes higjieno-sanitare dhe kopje akti për mbrojtjen nga zjarri, lëshuar nga institucionet përgjegjëse.

h) Kopje të mandatpagesës së tarifës së aplikimit.

Dokumentacioni në gjuhë të huaj ngarkohet i përkthyer në gjuhën shqipe. Kur ky dokumentacion lëshohet në gjuhë të huaj, nga një institucion i huaj, ai duhet të legalizohet, në bazë të legjislacionit në fuqi.

SHTOJCA NR. 3

Tarifat e aplikimit për hapje të institucioneve arsimore parauniversitare private, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, janë si më poshtë:

Nr.	Institucionet	Tarifa në lekë
1	Kopsht	35 000 (tridhjetë e pesë mijë)
2	Shkollë e arsimit fillor	45 000 (dyzet e pesë mijë)
3	Shkollë e arsimit të mesëm, të ulët	45 000 (dyzet e pesë mijë)
4	Shkollë e arsimit bazë	55 000 (pesëdhjetë e pesë mijë)
5	Shkollë e arsimit të mesëm, të lartë	70 000 (shtatëdhjetë mijë)

SHTOJCA NR. 4

FORMULAR APLIKIMI

PËR MBYLLJEN ME KËRKESË TË SUBJEKTIT TË INSTITUCIONIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PRIVAT NË TË CILIN ZHVILLOHEN EDHE LËNDË FETARE APO KU MËSIMI ZHVILLOHET EDHE NË GJUHË TË HUAJ

Subjekti: _____
NIPT: _____
Administratori/përfaqësuesi:_____
NID i administratorit/përfaqësuesit:_____

Unë i/e nënshkruari/a _____, administrator/përfaqësues i subjektit _____ për institucionin e arsimit parauniversitar privat_____, kërkoj mbylljen e këtij institucioni për arsyet si më poshtë:

Arsyet e mbylljes së institucionit:

_____
_____
_____
_____

Të dhëna për institucionin:

- Emërtimi i institucionit arsimor parauniversitar:

_____

- Lloji i institucionit arsimor:

_____

- Vendndodhja e institucionit:

_____

- Viti shkollor i mbylljes së aktivitetit mësimor:

_____

- Numri i nxënësve për çdo klasë në vitin e fundit shkollor:

_____
_____

- Deklarimi për shlyerjen e të gjitha detyrimeve financiare ndaj nxënësve që kanë ndjekur institucionin arsimor, i cili kërkon të mbyllet:

_____
_____
_____

- Deklarimi për pajisjen e të gjithë nxënësve me dokumentacionin përkatës që i lejon ata transferimin në një institucion arsimor tjetër:

_____
_____

- Dokumenti që vërteton dorëzimin e dokumentacionit shkollor në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar ose në Drejtorinë Vendore të Arkivave.

Unë i nënshkruari *(emër, mbiemër)* deklaroj se të gjitha të dhënat e deklaruara në këtë formular janë të sakta dhe mbaj përgjegjësi të plotë ligjore.

SHTOJCA NR. 5

FORMULAR APLIKIMI
PËR NDRYSHIMIN E TË DHËNAVE TË INSTITUCIONIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PRIVAT NË TË CILIN ZHVILLOHEN EDHE LËNDË FETARE APO KU MËSIMI ZHVILLOHET EDHE NË GJUHË TË HUAJ

Datë ... .

Subjekti:_____
NIPT:_____
Administratori/përfaqësuesi:_____
NID i administratorit/përfaqësuesit:_____

Unë i/e nënshkruari/a _____, administrator/përfaqësues i subjektit _____, për institucionin e arsimit parauniversitar privat _____, deklaroj ndryshimin e të dhënave të institucionit si më poshtë:

- Vendndodhja e re e institucionit, shoqëruar me relacionin nga eksperti i licencuar:
_____

- Numri i klasave paralele (kur shtohet/pakësohet):

_____

- Struktura e vitit shkollor, plani mësimor ose programi mësimor i ndryshuar, shoqëruar me atë ekzistues:
_____

- Aspekte ndryshimeve të infrastrukturës të objektit shoqëruar me relacionin nga eksperti i licencuar:
_____

Dokumente shoqëruese:
- Relacion nga eksperti i licencuar për përmbushjen e standardeve të infrastrukturës të godinës së re ku do të zhvillohet veprimtaria mësimore apo ekzistuese kur ndryshohen aspektet të infrastrukturës.
- Deklaratë për numrin e klasave paralele që shtohen/pakësohen.
- Struktura e vitit shkollor, plani mësimor ose programi mësimor, të ndryshuar, shoqëruar me atë ekzistues.

Unë i nënshkruari *(emër, mbiemër)* deklaroj se të gjitha të dhënat e deklaruara në këtë formular janë të sakta dhe mbaj përgjegjësi të plotë ligjore.

SHTOJCA NR. 6
STANDARDE TË INFRASTRUKTURËS SË OBJEKTIT SHKOLLOR

1. Standardet normative të infrastrukturës që duhet të përmbushë objekti që do të funksionojë si institucion arsimor parauniversitar privat janë:

1.1 Kritere të përgjithshme:

a) Objektet arsimore që vihen në dispozicion për nivele të ndryshme arsimimi (kopshte, shkollë 9-vjeçare dhe shkollë e mesme) të kenë mjedise që nuk komunikojnë me njëri-tjetrin.

b) Objektet arsimore duhet të jenë të pajisura me pikën e ndihmës së shpejtë dhe pajisjet e nevojshme në të.

c) Objektet arsimore duhet të kenë sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit.

ç) Objektet arsimore të jenë të ndërtuara me materiale cilësore bashkëkohore dhe të plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për nxënësit, duke shmangur elementet e rrezikshmërisë. Materialet e përdorura për ndërtimin e tyre nuk duhet të kenë elemente përbërëse të dëmshme për shëndetin e nxënësve. Këto materiale duhet të sigurojnë akustikë të mirë në mjedisin e mësimit dhe të jenë izoluese ndaj zhurmave dhe luhatjeve të temperaturës.

d) Objektet arsimore duhet të jenë larg zonave industriale, varrezave apo zonave me ndotje mbi normat e lejuara. Në ndërtesat e shkollave vëmendje duhet t'i kushtohet izolimit akustik.

dh) Objektet arsimore të kenë sistem ngrohjeje dhe burime alternative për furnizimin me ujë dhe energji elektrike.

1.2 Për objektet e shkollave:

a) Për shkollat e arsimit bazë duhet të jenë në dispozicion minimumi 9 klasa mësimore për arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët dhe 2 mjedise për personelin mësimor. Për shkollat e arsimit fillor duhet të jenë në dispozicion minimumi 5 klasa mësimore dhe 1 mjedis për personelin mësimor. Për arsimin e mesëm të ulët duhet të jenë në dispozicion minimumi 4 klasa mësimore dhe 2 mjedise për personelin mësimor. Për arsimin e mesëm të lartë duhet të jenë në dispozicion minimumi 4 klasa mësimore dhe 2 mjedise për personelin mësimor.

b) Lidhur me normativën e ndriçimit natyral duhet që sipërfaqja e dritareve të mbulojë minimalisht 15% të sipërfaqes së dyshemesë dhe ndriçimi duhet të jetë në krahun e majtë të nxënësit, mundësisht i orientuar nga juglindja. Ndriçimi të realizohet me dritare me xham të tejdukshëm. Dritaret nuk lejohet të vendosen në murin ku është vendosur dërrasa e zezë. Hapësirat e nxënësve në ndërtimet e reja duhet të kenë një sipërfaqe totale me dritare prej së paku:

i. 8% e sipërfaqes së dyshemesë nëse dritaret janë nga jugu dhe lidhen drejtpërdrejt me mjediset e jashtme;

ii. 10% e sipërfaqes së dhomës nëse dritaret orientohen nga lindja apo nga perëndimi;

iii. 15% të sipërfaqes së dyshemesë së dhomës nëse dritaret shohin nga veriu;

iv. 20% e sipërfaqes së dhomës nëse dritaret nuk janë në një mur të jashtëm.

c) Klasat mësimore të kenë një normativë sipërfaqeje shfrytëzimi, prej:

i. minimumi 1.2–1.4 m² për çdo nxënës të grup-moshës nga 6–11 vjeç;

ii. minimumi 1.2–1.4 m² për çdo nxënës të grup-moshës nga 11–15 vjeç;

iii. minimumi 1.4–1.6 m² për çdo nxënës të grup-moshës nga 15–18 vjeç.

ç) Nyjat hidrosanitare të përfshijnë 1 boks për 40 djem dhe 2 lavamanë, 1 boks për 30 vajza dhe 2 lavamanë, si dhe 1 boks për administratën dhe 1 lavaman.

d) Për edukimin fizik duhet të ketë në dispozicion:

i. për shkollat fillore, nëse është e mundur, shkollat fillore duhet të kenë salla të veçanta të edukatës fizike me përmasa të fushës 12 m × 24 m dhe me përmasa totale 15 m × 27 m dhe lartësi minimale 6 m, një sipërfaqe totale prej 405 m²;

ii. shkollat 9-vjeçare, duhet të kenë patjetër një mjedis të veçantë të mbyllur (palestër) për edukimin fizik , si dhe në mjediset në oborrin e jashtme të saj. Përmasat të jenë 12m×24m dhe lartësia minimale 6m;

iii. shkollat e mesme duhet të kenë patjetër një mjedis të veçantë të mbyllur (palestër) për edukimin fizik, si dhe në mjediset në oborrin e jashtëm të saj. Përmasat të jenë 18m×26m.

dh) Objektet arsimore me mbi 200 nxënës duhet të jenë të pajisura me dalje dhe shkallë emergjence.

e) Objektet arsimore të krijojnë kushtet për shfrytëzimin e hapësirave për personat me aftësi të kufizuara (rampë), sipas përcaktimeve të rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara".

ë) Të gjitha mjediset e mësimit duhet të jenë me sistem interneti dhe të kenë pozicionin e instalimit të videoprojektorëve.

f) Shkollat mund të jenë 1 (një), 2 (dy) ose 3 (tre) kate mbi tokë. Nuk është e këshillueshme që të kalojnë tri kate mbi tokë për arsye sigurie. Vetëm në raste shumë të veçanta në zonat urbane shumë të dendura, ku sipërfaqja e truallit është e vogël ose për arsye madhore, grupi i projektuesve mund të propozojë shkolla deri në katër kate.

g) Në hapësirat e jashtme të shkollave duhet të ketë:

i. hapësirë sportive (fushë loje) – e përcaktuar nga kurrikula;

ii. hapësira e oborrit – 1 m²/nxënës;

iii. hapësira e qarkullimit (rrugë, trotuare) – 20% e hapësirës së jashtme;

iv. hapësira e gjelbër dhe ato të mbjella me dru dekorativë – 30% e hapësirës së jashtme.

gj) Laboratorët për shkollat 9-vjeçare:

i. një klasë laborator kimie, një fizike, një biologjie, një i gjuhëve të huaja (shërben edhe kabineti i informatikës) për shkolla me 18 klasa;

ii. për çdo 4 klasa më tepër shtohet nga një laborator;

iii. hapësira për klasat laboratorike për çdo nxënës duhet të jetë 2.2 m²;

iv. të llogariten mjedise ndihmëse për pajisjet dhe parapërgatitjet.

h) Laboratorët për shkollat e mesme të larta:

i. një klasë laborator kimie, një fizike, një biologjie, një i gjuhëve të huaja (shërben edhe kabineti i informatikës) për shkolla me 12 klasa;

ii. për çdo 3 klasa më tepër shtohet nga një laborator;

iii. hapësira për klasat laboratorike për çdo nxënës duhet të jetë 2.2 m²;

iv. të llogariten mjedise ndihmëse për pajisjet dhe parapërgatitjet.

1.3 Për objektet e kopshteve:

a) Objektet e kopshteve duhet të projektohen me 1 kat ose maksimumi 2 kate mbi tokë.

b) Së paku një nga hyrjet, mundësisht hyrja kryesore në ndërtesë, të jetë e aksesueshme për PAK (me aftësi ndryshe), sipas përcaktimeve në vendimin nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave "Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara".

c) Brenda hapësirës që i përket kopshtit duhet të parashikohen mjediset e jashtme të gjelbëruara dhe këndi i lojërave, më sipërfaqe 0.5 m²/ fëmijë.

ç) Për kopshtet duhet të jenë në dispozicion minimumi 3 klasa mësimore.

d) Sipërfaqja e shfrytëzueshme e gjithë objektit të kopshtit për fëmijë duhet të jetë si më poshtë:

i. Për kopshtet me ushqim në zonat urbane:

i.1 Me një grup: 4,35 m²/fëmijë;

i.2 Me dy grupe: 3,88 m²/fëmijë;

i.3 Me tri grupe: 3,56 m²/fëmijë;

i.4 Me gjashtë grupe: 3,53 m²/fëmijë.

ii. Për kopshtet pa ushqim në zonat urbane:

ii.1 Me një grup: 3,96 m²/fëmijë;

ii.2 Me tri grupe: 3,48 m²/fëmijë;

ii.3 Me katër grupe: 3,32 m²/fëmijë.

iii. Për kopshtet me ushqim në zonat rurale:

iii.1 Me një grup 5,4 m²/fëmijë;

iii.2 Me tri grupe 4,4 m²/fëmijë;

iii.3 Me katër grupe 4,33 m²/fëmijë;

iii.4 Me gjashte grupe 4,17 m²/fëmijë.

iv. Për kopshtet pa ushqim zonat rurale:

iv.1 Me një grup 4,8 m²/fëmijë;

iv.2 Me tri grupe 3,9 m²/fëmijë;

iv.3 Me katër grupe 3,9 m²/fëmijë.

dh) Shërbimet higjienike vendosen në një ambient të veçantë dhe të ketë ujë të rrjedhshëm.

Numri i bokseve dhe i lavamanëve, sipas akteve nënligjore në fuqi. Banjat duhet të kenë porta që hapen nga jashtë dhe të shkëputura nga dyshemeja. Pajisjet e banjave duhet të jenë të përshtatshme për moshën e fëmijëve.

VENDIM
Nr. 467, datë 10.6.2020

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. ARBEN HYSKO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 42, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2020", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Arben Hysko, në masën 1 000 000 (një milion) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 468, datë 10.6.2020

PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NË FSHATIN VALIAS, BASHKIA KAMZË, DHE CAKTIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "iii" dhe "iv", e 16, pika 3, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen zonë e re për zhvillim të territorit, me sipërfaqe prej 86 710 (tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e dhjetë) m^2, si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë.

2. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit për këtë zonë, si njësi zbatuese, për:

a) ndërtimin e banesave të reja ose të ndërtesave publike të dëmtuara;

b) ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike e kritike;

c) realizimin e ndërtimeve në këtë zonë;

ç) çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të kësaj zone.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Kamzë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Pika	Koord_X	Koord_Y
1	394180.8763	4582895.223
2	394187.438	4582958.829
3	394201.408	4583079.903
4	394202.8897	4583102.128
5	394218.5531	4583115.675
6	394258.5582	4583111.23
7	394278.8782	4583121.601
8	394361.005	4583095.99
9	394379.2084	4583097.048
10	394378.3617	4583120.12
11	394495.6253	4583170.496
12	394570.8729	4583200.818
13	394598.3897	4583137.847
14	394609.5022	4583132.026
15	394642.5752	4583068.79
16	394537.8	4583019.578
17	394456.3081	4582985.711
18	394447.3123	4582916.39
19	394431.9664	4582876.173
20	394382.2247	4582874.057
21	394361.8517	4582861.621
22	394337.51	4582865.061
23	394305.4953	4582871.675
24	394280.6245	4582880.671
25	394180.8763	4582895.223

Pika	Koord_X	Koord_Y
1	394180.8763	4582895.223
2	394187.438	4582958.829
3	394201.408	4583079.903
4	394202.8897	4583102.128
5	394218.5531	4583115.675
6	394258.5582	4583111.23
7	394278.8782	4583121.601
8	394361.005	4583095.99
9	394379.2084	4583097.048
10	394378.3617	4583120.12
11	394495.6253	4583170.496
12	394570.8729	4583200.818
13	394598.3897	4583137.847
14	394609.5022	4583132.026
15	394642.5752	4583068.79
16	394537.8	4583019.578
17	394456.3081	4582985.711
18	394447.3123	4582916.39
19	394431.9664	4582876.173
20	394382.2247	4582874.057
21	394361.8517	4582861.621
22	394337.51	4582865.061
23	394305.4953	4582871.675
24	394280.6245	4582880.671
25	394180.8763	4582895.223

VENDIM
Nr. 469, datë 10.6.2020

PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE RRËSHEN, BASHKIA MIRDITË, DHE CAKTIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "iii" dhe "iv", e 16, pika 3, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen zonë e re për zhvillim të territorit, me sipërfaqe prej 36 387 (tridhjetë e gjashtë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) m^2, si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, në njësinë administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë.

2. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit për këtë zonë, si njësi zbatuese, për:

a) ndërtimin e banesave të reja ose të ndërtesave publike të dëmtuara;

b) ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike e kritike;

c) realizimin e ndërtimeve në këtë zonë;

ç) çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të kësaj zone.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Mirditë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Pika	Koord_X	Koord_Y
1	406264.3861	4624673.983
2	406260.1263	4624669.116
3	406257.9062	4624667.39
4	406256.3948	4624667.553
5	406220.4114	4624676.02
6	406211.4156	4624676.549
7	406199.2447	4624670.728
8	406171.1988	4624644.27
9	406144.2113	4624623.632
10	406126.7487	4624641.095
11	406128.8654	4624646.386
12	406128.8654	4624651.149
13	406128.8654	4624655.911
14	406075.9486	4624704.066
15	406102.9362	4624760.157
16	406122.5154	4624799.316
17	406141.0363	4624828.949
18	406175.4322	4624877.103
19	406208.2406	4624845.353
20	406219.3531	4624855.937
21	406223.0573	4624853.82
22	406241.5781	4624876.045
23	406248.4573	4624879.749
24	406254.9243	4624882.74
25	406258.5456	4624883.029
26	406272.4556	4624866.875
27	406289.2832	4624843.38
28	406301.6657	4624823.537
29	406313.7307	4624807.503
30	406321.0332	4624800.041
31	406322.7795	4624797.025
32	406323.097	4624793.85
33	406322.7795	4624790.675
34	406321.3507	4624786.548
35	406316.5882	4624779.721
36	406278.7056	4624736.243
37	406274.3865	4624726.82
38	406271.3444	4624718.285
39	406270.7312	4624710.2
40	406270.3156	4624692.479
41	406269.5974	4624685.28
42	406269.2807	4624683.899
43	406267.7084	4624679.388
44	406264.3861	4624673.983

VENDIM
Nr. 471, datë 6.1.2020

PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. NIKOLLAQ TASI KANXHERI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Nikollaq Tasi Kanxheri, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 472, datë 6.1.2020

PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. BASHKIM ZANO AHMETI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Bashkim Zano Ahmeti, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 473, datë 6.1.2020

PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. ALFRED PANDO BUHALJOTI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Alfred Pando Buhaljoti, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 197, datë 11.6.2020

PËR MIRATIMIN E "RREGULLAVE PËR PËRZGJEDHJEN ME SHORT TË ÇËSHTJEVE NË PROCESIN E VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT"

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147, pika 1, shkronja "a", të Kushtetutës, nenet 2, 68–72, 74–78, 84–95, 97 dhe 171, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019, "Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve", me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

1. Miratimin e "Rregullave për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe

profesional të gjyqtarit", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë e Skemës së Vlerësimit të Gjyqtarëve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETAR
Naureda Llagami

RREGULLA
PËR PËRZGJEDHJEN ME SHORT TË ÇËSHTJEVE NË PROCESIN E VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT

KREU I
PARIME TË PËRGJITHSHME

1. Përzgjedhja e çështjeve me short realizohet pas fillimit të procedurës së vlerësimit dhe është pjesë përbërëse e kësaj procedure.

2. Përzgjedhja e çështjeve me short realizohet në mënyrë elektronike nga administrata gjyqësore. Kur kjo nuk është e mundur shorti zhvillohet në mënyrë manuale.

3. Shorti zhvillohet në ambientet e gjykatës, ku gjyqtari ka ushtruar më gjatë detyrën gjatë periudhës së vlerësimit.

4. Shorti konsiston në një përzgjedhje rastësore të çështjeve dhe realizohet në mënyrë transparente në praninë e detyrueshme të nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, të kancelarit, një sekretareje gjyqësore dhe të nëpunësit të gjykatës, që punon në fushën e teknologjisë së informacionit. Kanë të drejtë të marrin pjesë, vetë gjyqtari subjekt vlerësimi, çdo anëtar i Komisionit për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, si dhe një punonjës IT i KLGJ-së.

5. Data, ora dhe vendi i zhvillimit të shortit përcaktohen me vendim të relatorit, i cili i njoftohet gjyqtarit, kancelarit dhe kryetarit të gjykatës, jo më vonë se 2 ditë para ditës së organizimit të shortit.

6. Kryetari dhe kancelari i gjykatës marrin masa për t'i krijuar nëpunësit përgjegjës të gjitha kushtet e nevojshme për ushtrimin e detyrës.

7. Mbi bazën e tabelave statistikore dhe seksionin ku ka ushtruar detyrën gjyqtari, relatori përcakton me vendim numrin dhe kategoritë e çështjeve që do të përzgjidhen me short, për secilin vit vlerësimi. Përzgjedhja duhet të jetë e tillë që të përfaqësojë të gjithë punën profesionale të gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

8. Nëse gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtari ka munguar në detyrë për më shumë se 6 muaj, numri i çështjeve që përzgjidhen për vlerësim etik dhe profesional, përkatësisht 15 ose 6 çështje për vlerësim të përgjithshëm dhe jo më shumë se 6 ose 3 çështje për ato të vendosura tej afateve standarde, në varësi të periudhës së vlerësimit, do të ulet në mënyrë proporcionale me kohën.

9. Në short përfshihen të gjitha çështjet në të cilat gjyqtari ka qenë relator i trupit gjykues, duke përfshirë edhe ato të përfunduara prej tij si i transferuar përkohësisht apo i caktuar për çështje të veçanta, në një gjykatë tjetër nga ajo ku ai ushtron funksionin.

KREU II
KRITERET MBI TË CILAT RELATORI PËRCAKTON NUMRIN DHE KATEGORITË E ÇËSHTJEVE QË DO TË PËRZGJIDHEN ME SHORT

10. Numri total i çështjeve që do të përzgjidhen me short përcaktohet nga relatori në zbatim të nenit 91 të ligjit për statusin, në varësi të periudhës së vlerësimit, bazuar në kriteret e mëposhtme:

a) Kriteri vjetor për vlerësimin e përgjithshëm

Sipas këtij kriteri, relatori përcakton numrin e çështjeve që do të përzgjidhen për procesin e vlerësimit referuar periudhës së vlerësimit, si më poshtë:

i. nëse vlerësimi është pesëvjeçar, do të përzgjidhen 3 çështje për çdo vit kalendarik;

ii. nëse vlerësimi është trevjeçar, do të përzgjidhen 5 çështje për çdo vit kalendarik;

iii. nëse vlerësimi është 1-vjeçar (i përshpejtuar), do të përzgjidhen 6 çështje.

b) Kriteri i vonesës në afate

Sipas këtij kriteri relatori përcakton numrin e çështjeve që do të përzgjidhen, sipas vonesës në afate, referuar tabelës së hartuar nga nëpunësi përgjegjës, menjëherë pas fillimit të procesit të vlerësimit, sipas formatit standard (aneksi i bashkëlidhur këtij akti). Nëse gjyqtari ka çështje të gjykuara përtej afateve standarde (ligjore dhe standard minimal kohor), atëherë prej tyre përzgjidhen 5%, por jo më shumë se 6 çështje. Në rastin e vlerësimit 1-vjeçar, numri i çështjeve që

përzgjidhen është sërish 5%, por jo më shumë se 3 çështje.

11. Numri i çështjeve që do të përzgjidhen me short, për vlerësim të përgjithshëm, sipas kategorive, përcaktohet nga relatori në zbatim të nenit 91 të ligjit për statusin, në varësi të periudhës së vlerësimit, bazuar në kriteret e mëposhtme:

a) Kriteri gjithëpërfshirës i përzgjedhjes

Sipas këtij kriteri, relatori duhet të kujdeset që përzgjedhja të mbulojë plotësisht të gjitha llojet e çështjeve të gjykuara nga gjyqtari subjekt vlerësimi. Për këtë qëllim relatori përcakton numrin e çështjeve që do të përzgjidhen mbi bazën e tabelave statistikore, ku përfshihen edhe çështjet e përfunduara nga gjyqtari në një gjykatë tjetër nga ajo ku ai ka ushtruar funksionin, si i transferuar përkohësisht apo i caktuar për çështje të veçanta. Për lehtësimin e punës dhe për zhvillimin e shortit, menjëherë pas fillimit të procesit të vlerësimit, mbi bazën e tabelave statistikore të dërguara, nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, nën mbikëqyrjen e relatorit, përfshin në një tabelë të vetme statistikore, sipas natyrës së çështjes, ato të përfunduara në të njëjtin vit kalendarik, në gjykata të tjera ku gjyqtari ka qenë i transferuar apo caktuar për gjykimin e çështjeve të veçanta.

b) Kriteri i barazisë në përzgjedhjen e çështjeve

Sipas këtij kriteri, relatori përcakton numrin e çështjeve që do të përzgjidhen, në varësi të numrit të çështjeve të përfunduara, me qëllim përzgjedhjen në mënyrë të barabartë të çështjeve për secilën kategori, në varësi të raportit që zë numri i çështjeve të përfunduara për secilën kategori/tabelë, në numrin total të çështjeve.

c) Kriteri i natyrës së vendimit

Sipas këtij kriteri, relatori, pas përcaktimit të numrit total të çështjeve që duhet të përzgjidhen (vlerësim i përgjithshëm + çështjet e vonesës në afate), përcakton numrin maksimal të çështjeve të përfunduara me vendim jopërfundimtar që duhet të merren për vlerësim, nëse shorti do të përzgjedhë të tilla. Ky numër nuk duhet të jetë më i lartë se 10% e numrit të përgjithshëm të çështjeve të përzgjedhura.

ç) Kriteri i kompleksitetit të çështjes

Sipas këtij kriteri, relatori përcakton numrin e çështjeve pa palë kundërshtare që duhet të përzgjidhen si kategori më vete, në varësi të raportit që zënë çështjet e përfunduara pa palë kundërshtare në numrin total të çështjeve. Ky numër nuk duhet të jetë më i lartë se 20% e numrit të përgjithshëm të çështjeve të përzgjedhura. Bazuar në tabelat statistikore, relatori përcakton kategorinë dhe vitin kalendarik nga i cili këto çështje do të përzgjidhen me short.

KREU III
RREGULLAT E ZHVILLIMIT TË SHORTIT NË GJYKATË

12. Shorti zhvillohet mbi bazën e listës së plotë të çështjeve gjyqësore të gjykuara nga gjyqtari.

13. Procedura e shortit ndjek disa hapa përzgjedhës të çështjeve, sipas vendimit të relatorit e radhës së mëposhtme.

14. Çdo hap përzgjedhës bazohet në të dhëna statistikore pjesë e një tabele të caktuar për kategori çështjesh.

15. Procedura e shortit fillon me përzgjedhjen në mënyrë rastësore të çështjeve për të cilat është vendosur përtej afateve standarde, bazuar në formatin tabelar të hartuar nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin.

16. Më pas vazhdohet me përzgjedhjen e çështjeve për vlerësimin e përgjithshëm, sipas kategorive të çështjeve e tabelave statistikore të përcaktuara në vendimin e relatorit. Në përzgjedhjen e çështjeve për vlerësim të përgjithshëm, përjashtohen ato që janë përzgjedhur sipas pikës 15.

17. Për të kontrolluar nëse çështja e përzgjedhur me short përmbush kriteret e nenit 91 të ligjit për statusin dhe të këtyre rregullave, do të procedohet aty për aty me verifikimin fizik të vendimit gjyqësor, që ka zgjidhur çështjen. Nëse çështja nuk përmbush kriteret, atëherë ajo nuk konsiderohet dhe procedohet me përzgjedhjen e një çështjeje tjetër. Çështje e përzgjedhur me short nuk konsiderohet as ajo, vendimi gjyqësor i së cilës është përzgjedhur për vlerësim nga gjyqtari, sipas nenit 86 të ligjit për statusin.

18. Gjykata/t e tjera duhet të bashkëpunojnë, duke dërguar në kohë reale në vendin ku zhvillohet shorti, kopje të vendimeve, nëse ato përzgjidhen nga shorti. Për të verifikuar që çështjet e përzgjedhura përmbushin kriteret e shortit, dërgimi duhet të bëhet menjëherë me faks ose me postë elektronike, duke u dokumentuar në procesverbalin e shortit.

KREU IV
DOKUMENTIMI I SHORTIT DHE VËZHGIMI I DOSJEVE

19. Çdo veprim i kryer gjatë procedurës së shortit dokumentohet në një procesverbal, sipas formës standarde të miratuar.

20. Ky procesverbal mbahet nga një sekretare gjyqësore dhe nënshkruhet nga të gjithë të pranishmit. Nëse ka vërejtje për procedurën e zhvillimit të shortit, ato shënohen në një rubrikë të veçantë të procesverbalit.

21. Një kopje e procesverbalit i dorëzohet kancelarit të gjykatës për përgatitjen e dosjeve të përzgjedhura. Një kopje i dorëzohet gjyqtarit, ndërsa kopja origjinale bëhet pjesë e dosjes së vlerësimit.

22. Pas dokumentimit të shortit bëhet vëzhgimi i dosjeve për të parë nëse ato ndodhen në arkivin e gjykatës ku është zhvilluar shorti. Kancelari merr masa për fotokopjimin e të gjitha akteve të dosjeve të përzgjedhura, me përjashtim të fashikullit të prokurorit në çështjet penale dhe ia përcjell ato Këshillit, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga e nesërmja e zhvillimit të shortit. Aktet e dosjeve të përzgjedhura duhet të jenë të inventarizuara dhe të njësuara me vulën e gjykatës. Bashkë me aktet e fotokopjuara e të njësuara me origjinalin, duhet të dërgohet edhe kopja e regjistrimit audio të seancave.

23. Nëse pas vëzhgimit të dosjeve rezulton se ato ndodhen në arkivin e një gjykate tjetër, nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, njofton relatorin dhe me miratimin e tij i kërkon gjykatës tjetër, kopje të akteve të dosjes së përzgjedhur sipas procedurës dhe afateve të mësipërme.

KREU V
DISPOZITA KALIMTARE PËR GRADIMIN/PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT TË GJYQTARËVE QË KANË KALUAR PROCESIN E RIVLERËSIMIT

24. Për gradimin/përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, përzgjidhen me short për vlerësim 6 dosje shtesë. Nga kjo përzgjedhje, përjashtohen çështjet që janë pjesë e dosjes së rivlerësimit, sipas nenit 171, pika 5 të ligjit për statusin. Për të lehtësuar punën e procedurën e shortit, nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, evidenton paraprakisht çështjet e dosjes së rivlerësimit, të përzgjedhura nga gjyqtari, nga shorti, apo të analizuara mbi bazën e ankesave.

25. Përzgjidhen si pjesë e 6 dosjeve shtesë, vetëm çështjet me palë kundërshtare, për të cilat është disponuar me vendim përfundimtar.

26. Për zhvillimin e shortit, dokumentimin dhe dërgimin e dosjeve të përzgjedhura, zbatohen rregullat e mësipërme.

ANEKSI I
FORMAT TABELAR PËR ÇËSHTJET E VENDOSURA JASHTË AFATEVE STANDARDE

Ky format hartohet nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin dhe përmban të listuara vetëm çështjet me palë kundërshtare të përfunduara nga gjyqtari tej afateve standarde, në dy kolona:

1. Numrin rendor që tregon vendin në renditjen e vendimeve që do të shortohen; dhe

2. Numrin e regjistrit të çështjes, që ka gjykuar gjyqtari.

Në listën e këtyre çështjeve përfshihen edhe ato në të cilat gjyqtari ka qenë relator i trupit gjykues, si i transferuar përkohësisht apo i caktuar për çështje të veçanta, në një gjykatë tjetër nga ajo ku ai ushtron funksionin.

Tabela për çështjet me palë kundërshtare të përfunduara jashtë afateve standarde	
Nr. rendor	Nr. akti
1	
2	
3	

Hartoi
Nëpunësi përgjegjës

_____
(emër/mbiemër/nënshkrim)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 392 lekë